



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 112 Akti

Nr. 182 Vendimi

Tiranë, më 18.07.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Olsi Komici	Relator
Valbona Sanxhaktari	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, në Tiranë, në datën 15.7.2019, ora 09.15, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ardian Ylli**, prokuror/drejtuës i komanduar i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Ardian Ylli, vëzhguesin ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore

publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Ardian Ylli, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Ardian Ylli, ushtron detyrën e prokurorit/drejtuës i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.3.2018 në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Roland Ilia dhe Olsi Komici. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Olsi Komici.

Me vendimin nr. 2, datë 6.6.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Ardian Ylli, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisionerin Roland Ilia. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Mia Roessingh.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit (në vijim, Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, DSIK) dhe Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshëm.

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

ILDKPKI-ja, pasi ka kryer procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e

¹Me shkresën nr*** prot., datë 19.1.2018, të përbërë nga 18 fletë, është dërguar raporti i ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016.

organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Ardian Ylli.”

Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenin 14, të ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 21.6.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Ardian Ylli, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua, më datë 21.6.2019, mbi përbërjen e trupit gjykues, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfuara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike, më datë 11.7.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, më datë 15.7.2019, ora 9.30, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht. Ai parashitroi shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, z. Ardian Ylli, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Ardian Ylli ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

²Me shkresën nr. *** prot., datë 15.5.2019, dërgohet raporti i DSIK-së për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016.

³Me shkresën nr. *** prot., datë 14.9.2018, dërgohet raporti i Grupit të Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për subjektin e rivlerësimit, z. Ardian Ylli, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tri kriteret: të vlerësimit të pasurisë; të kontrollit të figurës; dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Me shkresën nr. *** prot., datë 19.1.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishtëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Ardian Ylli, i cili është subjekt deklarues në ILDKPKI që prej vitit 2003, me numër indeksi ***, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë - shtojca 2 në datën 30.1.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për çdo aset të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- b) Deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) Provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI;
- d) Provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016 si nga: Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe të gjitha bankat e nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale të tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., zyra noteriale, DRSSH-të etj;
- e) Deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) Shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; dhe iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë - shtojca 2, në zbatim të nenit 31/1⁴, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Ardian Ylli, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, datë 30.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

➤ Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë - shtojca 2

1. Apartament me sip. 108.5 m², ndodhur në Lagjen nr. *, Rr. “E”, pll. *, Durrës, e blerë nga ish- Ndërmarrja Komunale Banesa me kontratën nr. *** datë 24.3.1994, me vlerë 50,063 lekë dhe me pjesë takuese 100 %.**

Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes; dhe të ardhura nga babai i subjektit.

ZVRPP-ja Durrës ka konfirmuar regjistrimin e apartamentit me sip.108.50 m², me adresë Lagja “S”, pll. *** shk. *, ap*, Durrës⁵, në emër të Ardian dhe M Ylli.

Apartamenti me sip.108.5 m² ndodhur në Durrës është përfutur nga A, Ardian dhe M Ylli, nëpërmjet procedurave të privatizimit nga ish-Ndërmarrja Komunale Banesa, në vlerën 50,063 lekë.

⁴ Subjekti i rivlerësimit ka detyrim të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë në ILDKPKI.

⁵ Apartament me sip. 108.50 m², pll**, shk. **, ap**, z.k. ***, nr. pasurisë ***, vol*, f. ** në Lagjen “S”, Durrës.

Z. Ardian Ylli, përveç pjesës së tij takuese në këtë apartament ka përfituar pronësinë mbi pjesën tjetër, si pasojë e çeljes së trashëgimisë ligjore për shkak të vdekjes së babait të tij, z. A. Y, dhe heqjes dorë nga pasuria e përfituar me trashëgimi në favor të subjektit nga motrat e tij: A. B (Ylli), E.K (Y) dhe M.S (Y).

Në deklaratën vjetore të vitit 2003 subjekti ka deklaruar: *“Banesë 3+1 me vlerë 50,500 lekë me adresë L.**, Rr. S, Durrës me burim krijimi privatizim mbi banesën sipas ligjit të privatizimit”*.

Në deklaratën periodike të vitit 2007 subjekti ka deklaruar: *“Rikonstruksioni i banesës me sip.95 m² deklaruar në vitin 2003. Gjatë rikonstruksionit janë shtuar afërsisht 2 dhoma me sip.38 m². Burim krijimi: kredi në shumën 45,000 euro në “NBG”. Vlera 35,000 euro”*.

Subjekti, me deklaratën “Vetting” ka paraqitur një preventiv për “rikonstruksion apartamenti” me adresë Lagjja *, Durrës, me shumë totale të punimeve në vlerën 17,814.66 euro përgatitur nga inxhinier Sh në tetor të vitit 2007.

Komisioni ka konstatuar disa mospërputhje në deklaram për sa i përket: sipërfaqes së apartamentit, në deklaratën “Vetting”, subjekti e deklaroi 108.5 m², ndërsa në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2007 e ka deklaruar 95 m²; adresës së deklaruar, në deklaratën “Vetting” subjekti deklaroi adresën Lagjja **, Rr. “E”, ndërsa në deklaratën e vitit 2003 ka deklaruar adresën Lagjja ***, Rr. “S”; pjesës takuese, në deklaratën “Vetting” subjekti deklaroi pjesë takuese 100 %, ndërsa në deklaratën e vitit 2003 ka deklaruar se pjesa takuese është 50 %.

Subjekti në shpjegimet e tij ka deklaruar: *“Referuar sipërfaqes është i njëjti apartament, por në vitin 2007 kam deklaruar sipërfaqen e brendshme të ndërtesës, ndërsa në deklaratën “Vetting” kam deklaruar sipërfaqen reale sipas dokumentit hipotekor; referuar adresës, në fillimi kjo rrugë emërtohej si Rr. “S” dhe më pas me vendimin nr.***, datë 30.7.2004, të Këshillit Bashkiak kjo rrugë ndryshoi emërtimin në Rr. “E” që rezultoi të jetë dhe aktualisht; referuar pjesës takuese, është bërë lapsus nga ana ime pasi në vitin 2003 pjesa takuese e imja ka qenë 1/3, pasi babai ndërroi jetë në vitin 2012 u bë dëshmia e trashëgimisë dhe pjesa takuese e babait tim me deklaratën noteriale 3 motrat e mia hoqën dorë nga pjesa e babait dhe kështu pjesa takuese e imja u bë 2/3 dhe bashkëshortes 1/3”*.

Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacionin përkatës⁶ për të provuar shpjegimet e tij.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit lidhur me apartamentin e mësipërm dhe me shtesën, si dhe të depozitojë dokumentacion ligjor justifikues në lidhje me shumën e shpenzuar nga ana e tij për rikonstruksionin e apartamentit, si dhe për ndërtimin e shtesës me sip. 38 m² deklaruar në vlerën 35,000 euro.

Subjekti ka sqaruar: *“Në kohën e plotësimit të deklaratës së interesave private që i përket vitit 2007, unë kam deklaruar shumën e shpenzuar/investuar për shtesën dhe rikonstruksionin e banesës së privatizuar në vlerën 35.000 euro, pa specifikuar sa është investimi për shtesën dhe*

⁶ Kopje e certifikatës së pronësie ,datë 20.4.2016, bashkë me hartën treguese të regjistrimit; shkresa kthim përgjigje nr. *** datë 13.3.2019, e Bashkisë Durrës, bashkëlidhur fragment nga harta e adresave të bashkisë Durrës; vendimi nr. **, datë 30.7.2004, i Këshillit Bashkiak Durrës, për ndryshimin e emërimit të rrugës ku ndodhet banesa ime së bashku me listën e plotë të emërtimeve të reja të rrugëve në Bashkinë Durrës; shkresa nr. *** datë 11.8.2004, për konfirmimin e vendimit të Këshillit Bashkiak nga Prefekti i Qarkut Durrës; shkresa nr. ***, datë 13.3.2019, e ZVRPP-së Durrës; kartela e pasurisë së paluajtshme, harta treguese e regjistrimit, inventari i brendshëm i dosjes, kërkesë për aplikim; vendim nr. ***, datë 27.4.2012, i Gjykatës Shkallës Parë Durrës, mbi lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë pas vdekjes së babait; deklaratë noteriale me nr***, datë 31.3.2012, për heqjen dorë nga pjesa takuese pas vdekjes së babait, nga motrat e subjektit; kartela e pasurisë së paluajtshme të banesës së mësipërme; kontrata e shitblerjes e datës 23.3.1994, midis Ndërmarrjes Komonale Banesa Durrës, dhe të ndjerit AYlli; autorizim banimi, datë 10.6.1975, i Komitetit Ekzekutiv të Qytetit Durrës .

sa për rikonstrukcionin e banesës. Por, në deklaratën “Vetting” dhe përgjigjet e pyetësorëve të mëparshëm, kam saktësuar vlerat përkatëse, 17.814 euro (shtesa) dhe 17.185 euro (rikonstrukcioni i banesës ekzistuese, shtrimi i pllakave të dyshemesë, rinovim i sistemit elektrik, hidraulik etj). Për shkak të kohës që ka kaluar, rreth 12 vjet nga ndërtimi i shtesës dhe i rikonstrukcionit të banesës, nuk disponoj dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me shumat e shpenzuara.”

❖ Konkluzion

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga ZVRPP-ja Durrës, dokumentacionin e depozituar nga vetë subjekti, si dhe deklaratimet e tij, arrin në konkluzionin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin ligjor të depozituar, për sa i përket mënyrës së përfitimit të këtij apartamenti.

Për sa i përket dokumentacionit ligjor justifikues për punimet e kryera nga subjekti për rikonstrukcionin e apartamentit ekzistues në shumën 17,814 euro, referuar deklaratimeve të subjektit, kohës së largët të kryerjes së këtyre punimeve, si dhe duke marrë për referencë preventivin e rikonstrukcionit të apartamentit, Komisioni vlerësoi se deklaratimet e subjektit janë të bazuara dhe të mjaftueshme.

2. Shtesë anësore me sip. 38 m², në apartamentin me sip. 108.5 m², të ndodhur në Lagjen **, Rr. “E”, pallati ** Durrës. Kjo shtesë u ndërtua fillimisht me leje ndërtimi, më tej për shkak se nga fqinjët nuk i përfunduan pjesët përkatëse, u aplikua për legalizim.

Burimi i krijimit: Për ndërtimin e kësaj shtese (dhe për nevoja të tjera të familjes) u mor dhe kredia te “NBG” në vitin 2007, në shumën 45,000 euro.

ZVRPP-ja Durrës nuk ka konfirmuar regjistrimin e shtesës anësore me sip. 38 m² të regjistruar pranë saj.

Bashkia Durrës⁷ sqaron se me vendimin nr. **, datë 22.5.1999, të KRRT-së është miratuar leje ndërtimi për “shtesë nga mbrapa për pallatin ***”. Me vendimin, nr. **, datë 2.2.2001, të KRRT-së është miratuar “rifreskim i lejes së ndërtimit të vitit 2000”, për pallatin ***, ALUIZNI Durrës ka përcjellë në Komision formularin e vetëdeklarimit të datës *** ku subjekti ka deklaruar se ndërtimit është ngritur në vitin 2001.

Subjekti, në deklaratën periodike të vitit 2007, ka deklaruar “gjatë konstruksionit janë shtuar afërsisht edhe dy dhoma me sipërfaqe 38 m², me vlerë 35,000 euro.

Komisioni, në lidhje me këtë pasuri, ka konstatuar mospërputhje të vlerës së shtesës me sipërfaqe 38 m², deklaruar në deklaratën “Vetting” në vlerën 17,814.66 euro, dhe në deklaratën periodike të vitit 2007 e ka deklaruar në vlerën 35,000 euro. Po ashtu, subjekti nuk ka deklaruar këtë objekt në deklaratat periodike vjetore të pasurisë të viteve 2003 – 2006. Në lidhje me këtë problematikë është pyetur subjekti për të dhënë shpjegime i cili ka shpjeguar: “...në deklaratën e vitit 2007 kam pasur parasysh dhe kam deklaruar vlerën 35,000 euro për rikonstrukcionin e të gjithë shtëpisë, pra, të sipërfaqes ekzistuese dhe shtesës deri në përfundim të saj, ndërsa në deklaratën “Vetting” kam deklaruar vetëm vlerën e shtesës”

⁷ Shkresa nr. ***prot., datë 27.10.2016. e Bashkisë Durrës.

“...leja e ndërtimit për shtesën është marrë në vitin 1999 me vendim të KRRT-së Durrës dhe është rifreskuar në vitin 2001. Punimet për themelet janë kryer në vitin 2001 dhe kati i parë ka mbaruar me sa më kujtohet në fund të vitit 2001. Theksoj se fqinji i katit të parë e përfundoi shtesën, ndërsa karabinaja e katit të dytë është ndërtuar rreth fundit të vitit 2005. Theksoj se edhe aktualisht kati i dytë ka mbetur karabina. Në këto kushte pasi mbaroi karabinaja e katit të dytë dhe soleta, në vitin 2007, ndërkohë që kisha marrë edhe kredinë në NBG, kam filluar punimet për rikonstruksionin e banesës aktuale dhe në vijim kam filluar ndërtimin e pjesës së shtesës time (karabina, mure, etj.) deri në përfundimin e saj dhe të rikonstruksionit të banesës.

Duke qenë se unë nuk e kisha ndërtuar pjesën e shtesës sime deri në vitin 2007, për rrjedhojë nuk e kam deklaruar në vitet 2003 – 2006.

Vetdeklarimi tek ALUIZNI i se shtesa është ndërtuar në vitin 2001 është bërë duke i'u referuar faktit që leja e ndërtimit ishte rifreskuar në vitin 2001 dhe faktit që themelet janë ndërtuar së bashku me katin e parë në vitin 2001 dhe më pas, siç parashtrova më lart, ka vijuar ndërtimi i karabinasë së katit të dytë dhe në vijim kati i tretë dhe i katërt. Pra i jam referuar fillimit të ndërtimit të shtesës kur kam bërë vetëdeklarimin në ALUIZNI. Në datën 26.3.2019 jemi pajisur me lejen e legalizimit për këtë shtese”.

Subjekti ka depozituar dhe deklaratat noteriale⁸ të dy fqinjëve të tij të cilët deklarojnë se subjekti Ardian Ylli ka ndërtuar shtesën në katin e tij në vitin 2007.

Zyra e ALUIZNI-t Durrës ka të administruar dhe formularin e vetëdeklarimit të shtetasit R. M i cili ka deklaruar vitin 2005 si vit të ndërtimit të shtesës së katit të dytë (fqinji i katit të dytë). Komisioni i ka kërkuar subjektit të depozitojë dokumentacion ligjor justifikues në lidhje me punimet e kryera për ndërtimin e shtesës me sip. 38 m² deklaruar në shumën 17,185 euro.

Subjekti ka shpjeguar se për shkak të kohës që ka kaluar, rreth 12 vjet nga ndërtimi i shtesës dhe i rikonstruksionit të banesës, nuk disponon dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me shumat e shpenzuara. Për sa i përket shumës tjetër të shpenzuar, subjekti sqaron se shuma tjetër prej rreth 17,185 euro është shpenzuar pothuajse e plotë në rikonstruksionin e plotë të banesës ekzistuese. Konkretisht si në shtrimin e pllakave dhe dyshemesë, ashtu edhe në rinovimin e sistemit elektrik, hidraulik, investimin në pajisjet e domosdoshme shtëpiake, etj.

❖ Konkluzion

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga institucionet shtetërore, deklarimet e subjektit, si dhe deklaratat noteriale të pronarëve të kateve të tjera të shtesës, krijoi bindjen se ndërtimi i shtesës nga subjekti është realizuar në vitin 2007.

Për sa i përket dokumentacionit ligjor justifikues për punimet e kryera nga subjekti për rikonstruksionin e apartamentit ekzistues në shumën 17,185 euro, referuar deklarimeve të subjektit, kohës së largët të kryerjes së këtyre punimeve, si dhe duke marrë për referencë preventivin e ndërtimit të shtesës, Komisioni i gjen deklarimet e subjektit të bazuara dhe të mjaftueshme.

⁸ Deklarata noteriale, nr. *** datë 24.5.2019, me deklarues R M, i cili deklaroi që në vitin 2005 ka ndërtuar karabinanë për katin e tij, dhe fqinji i tij A. Ylli ka ndërtuar shtesën në vitin 2007; deklarata noteriale nr.***, datë 24.5.2019, me deklarues Th.J i cili deklaroi se ka përfunduar karabinanë e katit të tij në fillim të vitit 2008, ndërsa fqinji i tij A. Ylli e ka ndërtuar shtesën në vitin 2007.

3. **Automjet, tip “Mercedes Benz”,** E *** CDI, viti 2003, me targa AA ** LT, blerë me kontratën e datës ***⁹, në vlerën 2340 euro + 51,991 lekë dogana, në emër të djalit O Y, me pjesë takuese 25 %.

Burimi i krijimit: Të ardhurat familjare.

Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2014 (pjesa e deklarimit të djalit O Y) është deklaruar: *“Blerë mjeti ‘Mercedes Benz’, me targa AA *** JD, me kontratën e datës 12.4.2014, me vlerën 2,340 euro + 51,991 lekë detyrim doganor”.*

Subjekti nuk e ka deklaruar burimin e krijimit.

Nga dokumentacioni i përcjellë nga DPSHTRR-ja rezulton se, mjeti “Mercedes Benz” E*** CDI, rezulton i blerë nga shtetasi A S në shtetin italian në shumën 1,700 euro, si dhe ka paguar doganën e mjetit në vlerën 51,991 lekë.

Në kontratën e shitblerjes¹⁰ së datës 12.4.2014, me shitës A S dhe blerës O Y, është pasqyruar çmimi i blerjes në shumën 2,340 euro.

Në lidhje me mospërputhjen ndërmjet çmimit të blerjes së deklaruar nga djali i subjektit me çmimin e pasqyruar në kontratën e shitblerjes së mjetit, subjekti ka deklaruar: *“Kjo mospërputhje ka ardhur sepse për shkak të procedurave doganore, zhdoganimi duhej të bëhej nga shitësi A S, pasi sipas rregullave doganore, ky mjet është blerë nga vetë z. S në Itali dhe ky i fundit detyrohej të bënte deklaratën doganore dhe pagesën e doganës në emër të tij. Pavarësisht se shuma për pagesën e zhdoganimit të automjetit, i është dhënë nga ana ime, para hartimit të kontratës së shitblerjes, sepse kështu ramë dakord, mbasi është kryer pagesa e detyrimit doganor nga z. A S, mbas disa ditësh, është bërë kontrata e shitblerjes së automjetit midis tij dhe djalit tim O”.*

Referuar këtij deklarami subjekti ka depozituar dhe deklaratën noteriale të datës 12.03.2019¹¹ ku deklaruesi A S konfirmon deklaramin e subjektit, si dhe dokumentacionin tjetër për këtë mjet¹².

❖ **Konkluzion**

Komisioni vlerësoi dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRR, si dhe deklaramet e subjektit dhe konstaton se ato përputhen me njëra tjetrën për sa i përket deklaramit të mjetit.

Referuar konstatimit të mospërputhjes së çmimit të deklaruar nga subjekti me atë të pasqyruar në kontratën e shitblerjes për Komisionin, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit janë të plota dhe të mjaftueshme.

4. **Ambient me qira me sip. 172 m²,** kati i parë i ndërtesës, ndodhur në adresën Rr. “E”, Durrës, sipas kontratës së datës ***¹³ me qëllim zhvillimin e aktivitetit “shërbim bar” me afat deri 31.8.2018 (i pa aktivizuar në momentin e deklaramit) me qira mujore 60,000 lekë/muaj (dhe në momentin e lidhjes së saj janë paguar 180,000 lekë për tre muaj), në emër të djalit të subjektit O. Y.

⁹ Kontrata, nr. *** datë 12.4.2014.

¹⁰ Kontrata, nr. **, datë 12.4.2014, me shitës A. S dhe blerës O. Y me çmim 2,340 euro.

¹¹ Deklarata noteriale, nr. *** datë 12.3.2019, me deklarues A. S

¹² Kontratë shitblerje, nr. *** datë 12.4.2014; urdhër çlirim; fotokopje e pasaportës së shitësit A. S dhe blerësit O. Y; deklarata doganore së bashku me dokumentacionin italian të origjinës së mjetit dhe deklarata noteriale nr. **, e z. A. S.

¹³ Kontrata e qirasë, nr***, datë 23.7.2016.

QKB-ja ka konfirmuar se O.Y është i regjistruar, si person fizik “bar-kafe, vinotekë”, me NIPT L***V, me datë regjistrimi 16.2.2017, me status aktiv.

Kontrata e qirasë është lidhur në datën 23.7.2016. Në kontratë është specifikuar se nga 23 korrik deri 1 shtator 2016 nuk paguhet qira, pasi lokali do të përshtatet me aktivitetin privat të qiramarrësit, ndërkohë që regjistrimi si person fizik është bërë në datën 16.2.2017.

Komisioni ka kërkuar nga subjekti shpjegime në lidhje me: ushtrimin e aktivitetit të djalit O Y rreth 5 (pesë) muaj pa u regjistruar në organet tatimore për të paguar detyrimet ligjore; në lidhje me investimin duke dokumentuar vlerën e tij; si dhe në lidhje me të punësuar në këtë aktivitet.

Subjekti në përgjigje të tij ka deklaruar: “a)...nga kontrata e qirasë e datës 23.7.2016 parashikohej se aktiviteti do të fillonte në shtator të vitit 2016, pasi do të bëheshin punime etj., por dhe se qiradhënësit i ishin krijuar probleme në objekt nga qiramarrës të mëparshëm..... b) ...investimet në objekt janë kryer gjatë periudhës shkurt – prill të vitit 2017 në vlerën 2,064,100 lekë sipas faturave respektive¹⁴ c) ...gjatë ushtrimit të aktivitetit ka qenë e nevojshme punësimi i disa punonjësve sipas volumit të punës. Sipas listpagesave të dorëzuara në organet tatimore¹⁵ të cilat janë bashkangjitur këtij pyetësori, kanë qenë të punësuar nga 2 deri 6 të punësuar....”.

❖ Konkluzion

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga QKB-ja, dokumentacionin e depozituar nga vetë subjekti, si dhe deklaratimet e tij, konstatoi se në lidhje me ushtrimin e aktivitetit, me investimin në ambientin e ushtrimit, si dhe me të punësuarit në këtë aktivitet, subjekti ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse.

5. **Ambient me qira** në adresën L. **, Rr. “M.M” për ushtrimin e aktivitetit “Parukeri & estetike”, në emër të bashkëshortes, znj. M. Y.

Subjekti i rivlerësimit ka depozituar kontratat respektive të ambientit të marrë me qira nga shtetasja L B nga data 21.2.2006 deri 20.02.2011 (ndërprerë në v. 2010) me kontratat e qirasë datë 21.02.2006¹⁶, kontrata e qirasë datë 14.01.2008¹⁷ dhe kontrata e qirasë datë 20.02.2009¹⁸, me vlerë 10,000 lekë/muaj.

→ Komisioni nuk ka konstatuar ndonjë problematikë lidhur me këtë pasuri të deklaruar.

6. **Ambient me qira me sip. *** m²**, në L. ***, Rr. “M. M” për ushtrimin e aktivitetit “Parukeri & estetike”, në emër të bashkëshortes M Y.

Subjekti ka depozituar kontratat e qirasë së datës 24.6.2010¹⁹, me afat 1-vjeçar me qira 30,000 lekë/muaj, kontratën e qirasë së datës 17.4.2012²⁰ me afat 1-vjeçar, me qira 15,000 lekë/muaj dhe kontratën e qirasë së datës 17.09.2015²¹ me afat 1-vjeçar me qira 30,000 lekë/muaj.

Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime: mbi vlerën e investimit që është bërë në aktivitetin e bashkëshortes, vitin në të cilin është bërë ky investim duke e dokumentuar këtë vlerë; sa të

¹⁴ Subjekti ka depozituar faturat respektive të pagesave të bëra për punime dhe blerje të ndryshme.

¹⁵ Subjekti ka depozituar listpagesat në të cilat vërtetohet se për të punësuarit pranë aktivitetit të djalit O. Y, ai ka paguar sigurime shoqërore për të punësuarit e tij.

¹⁶ Kontrata e qirasë, nr. ***, datë 21.2.2006.

¹⁷ Kontrata e qirasë, nr. ***, datë 14.1.2008.

¹⁸ Kontrata e qirasë, nr. ***, datë 20.2.2009.

¹⁹ Kontrata e qirasë, nr. ***, datë 24.6.2010.

²⁰ Kontrata e qirasë, nr. ***, datë 17.4.2012.

²¹ Kontrata e qirasë, nr. ***, datë 17.9.2015.

punësuar ka pasur në këtë aktivitet; dhe në lidhje vlerën e qirasë e cila për të njëjtën sipërfaqe e njëjta qiradhënëse ka aplikuar një herë çmimin e qirasë 30,000 lekë/muaj, më pas 15,000 lekë/muaj dhe përsëri 30,000 lekë/muaj.

Subjekti në përgjigje të tij ka deklaruar: *“a) për vlerën e investimit të aktivitetit të bashkëshortes është marrë kredi në vlerën 250,000 lekë tek “NBG” në datën 5.12.2006 dhe kredi në vlerën 300.000 lekë në “BKT” në datën 31.1.2007. Këto vlera janë marrë për nevoja të ushtrimit të aktivitetit me NIPT K***I, aktivitet i cili ka filluar më 6.3.2006....ambienti i marrë me qira nuk kishte nevojë për investime, por nga ana jonë janë bërë disa blerje pajisesh për të cilat nuk disponojmë fatura për shkak të kohës që ka kaluar... b) në lidhje me të punësuarit...gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të aktivitetit të bashkëshortes, një pjesë të kohës ka qenë e vetëpunësuar vetëm bashkëshortja ime dhe në pjesën tjetër ka patur një punonjës të punësuar²²... c) në lidhje me vlerën e ndryshueshme të qirasë... shpjegohet me faktin se gjatë ushtrimit të aktivitetit në vitet 2010, 2011 dhe kryesisht në fillim të vitit 2012, kishte filluar një rënie e të ardhurave nga ushtrimi i aktivitetit... në këtë aspekt, bashkëshortja ime ra dakord me palën qiradhënëse për të ulur pak vlerën e qirasë, për të paktën një periudhë 1-vjeçare, me qëllim për ti dhënë një frymëmarrje këtij aktiviteti...*

❖ **Konkluzion**

Komisioni vlerësoi se subjekti ka depozituar kontratat që vërteton marrëdhënien e qirasë për ambientin ku ushtrohet aktiviteti i bashkëshortes “parukeri & estetikë”.

Në lidhje me të punësuarit në aktivitetin e bashkëshortes, subjekti ka depozituar vërtetimin e lëshuar nga ISSH-ja, ku vërtetohet se për të punësuarit pranë aktivitetit të saj, bashkëshortja e subjektit ka paguar sigurime shoqërore.

Për sa i përket ndryshimit të çmimit të qirasë Komisioni i gjen shpjegimet e subjektit të plota dhe të mjaftueshme.

7. Të ardhura nga aktiviteti i bashkëshortes “parukeri & estetikë” regjistruar në shkurt të vitit 2006 e në vijim (duke përjashtuar vitin 2014 kur aktiviteti u pezullua) në shumën 1,871,615 lekë.

QKB-ja ka konfirmuar se znj. M. Y është regjistruar si person fizik “zhvillim kursesh kualifikimi dhe formim profesional për parukeri”, me datë regjistrimi 1.4.2003 dhe çregjistruar në datën 24.3.2006.

QKB-ja ka konfirmuar se znj. M. Y është regjistruar si person fizik “Kurse kualifikimi dhe formim profesional për parukeri dhe estetik” me NIPT K***I, me datë regjistrimi 6.3.2006 ku në datën 31.5.2013 nga statusi “aktiv” u bë “pezulluar” dhe në datën 27.3.2015 nga statusi “i pezulluar” u bë “aktiv”.

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve ka konfirmuar se për subjektin M Y, me NIPT K***B, nga verifikimi në sistem rezultoi se subjekti është person fizik i regjistruar në datën 1.4.2003 dhe çregjistruar që nga data 6.3.2006. Nuk ka të dhënë tjetër për sigurimet apo të ardhurat. Nga dosja

²² Subjekti ka depozituar vërtetimin nr***, datë 13.3.2019, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës për të dhënat e të punësuarve për periudhën 2006 – 2012 dhe shkresën kthim përgjigje nr. *** datë 13.3.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, ku janë të dhënat e të punësuarve për vitet 2013 – 2017.

fizike e vënë në dispozicion nga arkiva ka informacion vetëm për të ardhurat e vitit 2003, qarkullimi xhiro gjithsej në vlerën 2,750,000 lekë.

Bashkia Durrës ka konfirmuar se për vitin 2007, personi fizik M. Y me NIPT K***I, ka deklaruar qarkullim vjetor në vlerën 1,000,000 lekë.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për tatimpaguesin M. Y me NIPT K***I, ka dërguar të dhënat tatimore për vitet 2006 – 2017.

Tabela krahasuese e deklarimeve të subjektit dhe të dhënat tatimore ndër vite.

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Deklaruar subjekti	1,000,000	1,250,000	600,000	702,000	432,000	300,000
Tatimet (të ardhurat)	991,620	1,000,000	1,100,000	1,320,026	1,261,740	1,216,941
Tatimet (fitimi)	-----	-----	600,000	779,960	480,000	300,000

Vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Deklaruar subjekti	480,000	180,000	pezulluar	1,099,402	1,871,615
Tatimet (të ardhurat)	1,469,087	690,886	-----	1,605,415	2,913,376
Tatimet (fitimi)	480,000	200,000	-----	1,099,402	1,871,615

Komisioni ka konstatuar:

- mospërputhje/pasaktësi në vlerat e deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike për të ardhurat e aktivitetit të bashkëshortes si person fizik, duke i krahasuar me të dhënat e vënë në dispozicion nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve;
- mosdeklarim nga subjekti i aktivitetit të bashkëshortes, si person fizik “parukeri” nga viti 2003 kur është regjistruar deri në vitin 2005 (pasi në datën 6.3.2006 është çregjistruar) me NIPT K3***B, si dhe mosdeklarim i qarkullimit për vitin 2003 në shumën 2,750,000 lekë dhe për këtë arsye subjektit iu dërgua pyetësi nr. 2, që të japë shpjegimet e tij.

Në lidhje me mospërputhjen në deklaratat periodike për të ardhurat e bashkëshortes me të dhënat e administruara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës subjekti duke i evidentuar sipas tabelës së mëposhtme:

Viti	Deklarimi periodik	Të dhënat nga tatimet	Mospërputhja
2006	1.000.000 lekë	991.620 lekë	+ 8.380
2007	1.250.000 lekë	0	0
2008	600.000 lekë	600.000 lekë	0
2009	702.000 lekë	779.960 lekë	-77.960
2010	432.000 lekë	480.000 lekë	-48.000
2011	300.000 lekë	300.000 lekë	0
2012	480.000 lekë	480.000 lekë	0

2013	180.000 lekë	200.000 lekë	-20.000
2014	pezulluar	0	0
2015	1.099.402 lekë	1.099.402 lekë	0
2016	1.871.615 lekë	1.871.615 lekë	0
2017	1.806.672 lekë	1.806.672 lekë	0

sqaron se paraprakisht diferencat në vite janë shumë të vogla. Këto diferenca, kanë ardhur sepse ai është nisur nga parimi për të bërë deklarime të sakta për fitimet neto të realizuara dhe jo të ardhurat bruto siç i paraqet organi tatimor.

Subjekti, në lidhje me këto deklarime, ka bashkëngjitur dhe dokumentacionin përkatës.

Në lidhje me ekzistencën e dy nipteve në emër të bashkëshortes, znj. M. Y, subjekti shpjegon: *“Në emër të bashkëshortes M.Y, me vendim nr. ***, datë 28.03.2003, të Gjykatës Shkallës Parë Durrës, është regjistruar aktiviteti “butik” dhe në organin tatimor është regjistruar me kod fiskal *** me datë 21.4.2003, sipas certifikatës së regjistrimit në organin tatimor, shkresa nr. ***, datë 12.3.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.*

*Me kërkesë të datës 14.1.2004, të bashkëshortes sime është kërkuar mbyllja e këtij aktiviteti. Gjithashtu më 24.10.2005, bashkëshortja ime, i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Shkallës Parë Durrës, për të bërë edhe formalisht çregjistrimin e këtij aktiviteti. Gjykata e Shkallës Parë Durrës me vendim nr. ***, datë 24.10.2005, ka vendosur, çregjistrimin e këtij aktiviteti”.*

Në lidhje me mosdeklarimin e qarkullimit për vitin 2003 në shumën 2,750,000 lekë subjekti ka deklaruar: *“Pavarësisht se është regjistruar si aktivitet, në fakt nuk është ushtruar aktiviteti dhe për rrjedhojë nuk janë realizuar të ardhura. Për shkak të mosushtrimit absolutisht të këtij aktiviteti dhe për rrjedhojë të mosrealizimit të ardhurave, në deklaratën e vitit 2003, kam menduar se nuk ishte e domosdoshme deklarimi i këtij fakti, pasi duke mos pasur të ardhura dhe fitime apo dhe detyrime, nuk do të ndikonin në deklaratimet e mija periodike. Ju sqaroj se bëhet fjalë për një nipt i cili nuk u aktivizua dhe nuk u ushtrua asnjëherë nga bashkëshortja ime dhe kjo ishte arsyeja që nuk e kam deklaruar në vitin 2003.”*

Drejtorja Rajonale Tatimore Durrës me shkresën e datës 13.3.2019²³ ka sqaruar ndër të tjera: *“... deklaratata e qarkullimit të xhiros për vitin 2003 me qarkullim xhiro gjithsej 2,750,000 lekë që gjendet në dosjen e subjektit është një parashikim fillestar në momentin e regjistrimit dhe të ardhura të realizuara.”*

Për sa i përket shpenzimeve të kryera në vitin 2006 për personin fizik me NIPT K*** subjekti ka deklaruar: *“Për të saktësuar se sa është fitimi neto për vitin 2006, nga korrespondenca e kryer me Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës, kjo e fundit konfirmon se sipas deklaratës vjetore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, është deklaruar një fitim prej 991.620 lekë.”*

²³ Shkresa nr*** prot., datë 13.3.2019, e DRT-së Durrës, drejtuar znj. M. Y

Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime në lidhje me shpenzimet e kryera për aktivitetin e bashkëshortes në vitin 2007 për NIPT-in K***I. Në përgjigjen e tij subjekti ka deklaruar shpenzimet²⁴ xhiro totale dhe fitim.

Komisioni, gjithashtu, konstatoi se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 dhe 2004 aktivitetin tregtar për personin fizik M. Y me NIPT K***B. Për këto dy konstatime, Komisioni i kërkoj dhe një herë shpjegime subjektit me rezultatet e hetimit të dërguara.

Subjekti ka deklaruar: “...shuma 540,000 lekë përfaqëson të ardhurat neto, por megjithatë shuma e tatimit prej 60,000 lekë është paguar respektivisht:

3(tre) këste x 6250 lekë = 18,750 lekë për vitin 2008, bashkangjitur mandat pagesat²⁵;

1(një) këst 6250 lekë i paguar në vitin 2009, bashkangjitur mandat pagesat²⁶;

1(një) këst 35,000 lekë si tatim shtesë i paguar po ashtu në vitin 2009, bashkangjitur mandate pagesat²⁷.

... për rrjedhojë shuma korrekte për tu marrë në analizë për vitin 2008 neto është në fakt shuma 581,250 lekë (540,000 + 35,000 + 6,250) dhe të ardhurat e vitit 2009, duhet të jenë 41,250 lekë (35,000 + 6,250) lekë më pak...

...unë e kam konsideruar fitimin neto në vlerën 600,000 lekë dhe duke mos marrë në konsideratë pagesën e kësteve të tatimit në vlerën prej 18.750 lekë, të paguara në vitin 2008 e për rrjedhojë, fitimi neto duhet të ishte 581.250 lekë...”

Subjekti, për sa i përket konstatimit të Komisionit, në lidhje me mosdeklarimin e NIPT K***B të bashkëshortes në vitin 2003 dhe ka dhënë të njëjtat shpjegime që ka dhënë në pyetësorët e mëparshëm, duke theksuar dhe një herë: “... për shkak të mos ushtrimit absolutisht të këtij aktiviteti dhe për rrjedhojë të mosrealizimit të ardhurave, në deklaratën e vitit 2003, kam menduar se nuk ishte e domosdoshme deklarimi i këtij fakti, pasi duke mos pasur të ardhura dhe fitime apo dhe detyrime, nuk do të ndikonin në deklaratimet e mija periodike. ...në vitin 2004, është bërë për herë të parë deklarimi i pasurisë nga ana ime, si dhe për të gjithë subjektet e tjera, për vitin 2003, dhe mungesa e pasqyrimit të këtij fakti, kam menduar se nuk do të përbënte shkelje nga ana ime, lidhur me pasqyrimin e një aktiviteti të regjistruar por pa të ardhura të realizuara...”

❖ **Konkluzion**

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucionet shtetërore, dokumentacionin e depozituar nga vetë subjekti, shpjegimet e subjektit gjatë hetimit dhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit, arrin në konkluzionin se subjekti ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse.

8. Llogari bankare të deklaruara

²⁴ Subjekti ka deklaruar shpenzimet si: blerje produktesh = 5825 lekë; taksat e bashkisë për vitin 2007 = 15,200 lekë; qiraja janar - dhjetor = 120,000 lekë (12 muaj x 10,000 lekë); energji elektrike janar - nëntor 2007 = 26,285 lekë; sigurime shoqërore + shëndetësore, janar - dhjetor 2007 = 52,356 lekë; ujësjellës Janar-Nëntor = 2240 lekë; Komisione bankare = 750 lekë.

²⁵ Manda pagesa nr. ***, datë 18. 4.2008, pasqyron shumën 22,350 lekë (6250 lekë + 16,100 lekë taksat locale); mandatpagesa nr. ***, datë 18.7.2008, pasqyron shumën 6250 lekë; mandatpagesa nr. ***, datë 17.10.2008, shuma 6,250 lekë.

²⁶ Mandatpagesa nr. ***, datë 19.1.09, shuma 6,250 lekë;

²⁷ Mandatpagesa nr. ***, datë 31.3.2009.

- a) Llogari kursimi Ardian Ylli në “Intesa Sanpaolo” krijuar në vitin 2014 me gjendje në vlerën 304,715 lekë. Burimi i krijimit nga të ardhurat pagat e subjektit.
- ❖ Konstatim: “Intesa Sanpaolo” konfirmon gjendjen e kësaj llogarie²⁸.
- b) Llogari kursimi, znj. M. Y, te “BKT” e krijuar në vitin 2015 me shtesa dhe pakësime ndër vite me gjendje aktuale në vlerën 16,701 lekë. Burimi i krijimit nga paga e bashkëshortes.
- ❖ **Konstatim:** “BKT”-ja konfirmon gjendjen e kësaj llogarie²⁹.
- c) Llogari kursimi në emër të djalit O. Y..te “Credins Bank” e krijuar në vitin 2014 me shtesa apo pakësime me gjendje aktuale në vlerën 500 lekë. Burimi i krijimit nga paga e bashkëshortes.
- ❖ **Konstatim:** “Credins Bank” konfirmon gjendjen e kësaj llogarie³⁰.
- ç) Llogari kursimi në emër të djalit R. Y tek “Credins Bank” e krijuar në vitin 2014 me shtesa apo pakësime me gjendje aktuale 10 euro. Burimi i krijimit nga paga e djalit R.Y.
- ❖ **Konstatim:** “Credins Bank” konfirmon gjendjen e kësaj llogarie³¹.

9. Gjendje *cash* në banesë në shumën 700,000 lekë.

Gjendja *cash* nga të ardhurat në vite ka qenë deri në datën 31.12.2015 në shumën 4,390,000 lekë.

Kursimet familjare në vitin 2016 janë shtuar në shumën 410,000 lekë. Nga këto kursime në datën 20.10.2016, në “Intesa Sanpaolo” është kredituar shuma 2,600,000 lekë për shlyerje të pjeshme të kredisë dhe në datën 30.12.2016, shuma 1,500,000 lekë për shlyerjen e pjeshme të kredisë. Aktualisht gjendja *cash* nga kursimet familjare është në shumën 700,000 lekë.

❖ Konkluzion

Komisioni konstatoi se deklarimi i subjektit në lidhje me shtesat dhe pakësimet e likuiditeteve ndër vite është i saktë dhe përputhet me gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën vetting.

10. Kredi e marrë në shumën 5,500,000 lekë, në datën 14.11.2014, në “Intesa Sanpaolo” për të blerë kredinë në “NBG” me kontratë hipotekore nr. ***, dhe kontratë kredie nr. ***, për afat 15 vjet. Detyrimi i pashlyer në shumën 863,979 lekë.

Qëllimi i marrjes së kësaj kredie është mbyllja e kredive të marra te “NBG” për 30,000 euro dhe 15,000 euro në vitin 2007. Ky veprim vërtetohet edhe me transaksionin bankar të datës 1.12.2014 ku shuma prej 5,175,225 lekësh me përshkrimin “mbyllje kredie” është transferuar nga llogaria bankare në ISPB-ja te llogaria bankare e Ardian Yllit në “NBG”, kredituar në datën 12.12.2004.

Përshkrim	Ref.	Vlera
Principali në fillim/14.11.2014	<i>a</i>	5,500,000
Principal i paguar në vitin 2014	<i>b</i>	30,598
<i>Principal në 31.12.2014 c = (a-b)</i>	<i>c</i>	5,469,402

²⁸Shkresa nr. *** prot., datë 14.5.2018, “Intesa Sanpaolo Bank”.

²⁹ Shkresa nr. ***prot., datë 17.5.2018, nga “BKT”.

³⁰ Shkresa nr. *** datë 19.7.2018, nga “Credins Bank”.

³¹ Shkresa nr. ***, datë 19.7.2018, nga “Credins Bank”.

Principal i paguar në vitin 2015	<i>d</i>	254,560
Principal në 31.12.2015 $e = (c-d)$	<i>e</i>	5,214,842
Principal i paguar në vitin 2016	<i>f</i>	2,843,589
Principal 31.12.2016 $g = (e-f)$	<i>g</i>	2,371,254
Principal deklaruar në Vetting		863,979
Diferencë		1,507,275

Komisioni, pasi analizoi deklaratimet e subjektit në lidhje me pagesat e kësteve të kredisë, konstatoi se ato përputhen me dokumentacionin e përcjellë nga bankat e nivelit të dytë.

11. Konstatime të tjera

a) Në lidhje me djalin subjektit, R. Y

QKB-ja konfirmon se R. Y rezulton si ortak me 17.2% të kapitalit në shoqërinë “E. F. V. A” sh.p.k. me datë regjistrimi 1.3.2012.

Nga ekstrakti i kësaj shoqërie rezulton se në datën 26.6.2012 kjo shoqëri ka kaluar nga statusi “aktiv” në statusin “pezulluar”.

DRT-ja Tiranë konfirmon se kjo shoqëri ka kaluar nga statusi “aktiv” në “pezulluar” në datën 28.6.2012 dhe më pas ka kaluar në statusin “pasiv” në datën 23.12.2014.

Shoqëria, “F.V.A” sh.p.k., për vitin 2012, 2013 dhe 2014 nuk rezulton të ketë realizuar të ardhura (qarkullim) në lekë. Po kështu, për muajt mars, prill, maj dhe qershor ka deklaruar dhe ka paguar kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, z. Ardian Ylli, nuk ka deklaruar aktivitetin e djalit të tij në deklaratën periodike të vitit 2012, dhe për këtë arsye i ka kërkuar shpjegime në lidhje me këtë mosdeklarim.

Subjekti në përgjigje të tij ka deklaruar: “...mosdeklarimi i këtij fakti, mbi qenien ortak i kësaj shoqërie, të djalit tim R Y, nuk ka ardhur me qëllim fshehjen apo mosdeklarimin e të ardhurave me dashje nga ana ime, por nuk kam pasur as dijeni në lidhje me këtë aktivitet të djalit. Sipas informacionit, kjo shoqëri ka ekzistuar vetëm 3 muaj dhe gjatë kësaj periudhë, ajo nuk ka kryer asnjë veprimtari, për shkak, të mungesës së legjislacionit përkatës, që normon legjitimitetin për të funksionuar me aktivitetin me të cilin ishte regjistruar kjo shoqëri. ... deklaroj me përgjegjësi të plotë se mosdeklarimi i këtij fakti, në asnjë moment nuk ka qenë për të mbuluar apo për të fshehur ndonjë veprimtari ekonomike apo të ardhur, pasi si dhe nga informacioni i organeve tatimore, veprimtaria e kësaj shoqërie ka qenë zero pasi nuk ka prodhuar të ardhura, fitime dhe nuk ka detyrime ndaj shtetit”.

❖ Konkluzion

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga institucionet shtetërore (QKB dhe DPT Tiranë), si dhe shpjegimet e subjektit, duke marrë në konsideratë dhe faktin se kjo shoqëri nuk

ka ushtruar veprimtari ekonomik-financiare, i gjen ato të mjaftueshme dhe në përputhje me njëra tjetrën.

b) Në lidhje me djalin e subjektit, O Y

Automjet, tip “Skoda Octavia” me targa AA *** KB e vitit 2002.

Në deklaratën periodike të vitit 2014, subjekti ka deklaruar: “*Blerë mjeti “Skoda Oktavia” me targa AA *** KB, në emër të O. Ylli, në datën 21.8.2014 në vlerën 1900 euro + 60,000 lekë doganë*”. Nuk është deklaruar burim krijimi.

Në deklaratën periodike të vitit 2015 subjekti ka deklaruar: “*Shitur mjeti “Skoda Octavia” me targa AA *** KB, në emër të O. Y, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 15.9.2015, në shumën 1600 euro*”.

DPSHTRR-ja ka përcjellë dosjen përkatëse të automjetit tip “Skoda Octavia”.

Deklarata e “pushimit të qarkullimit” në gjuhën frënge, e përkthyer në shqip, ku shtetasi Donis Sula me banim në Francë deklaroi se i ka shitur automjetin tip “Skoda Octavia”, me targa DH-*** TM, sot, në datën 21.9.2014, O Y, me banim në Durrës. Në këtë deklaratë shitje nuk është vendosur çmimi i shitjes.

Dokumenti doganor i datës 5.9.2014 pasqyron çmimin e mjetit 150,000 lekë dhe vlera doganore në shumën 34,308 lekë është paguar nga shtetasi D. S.

O.Y, këtë mjet me kontratën³² e datës 15.9.2015, ia ka shitur shtetasit A. Ç, me çmimin 1,600 euro (likuiduar jashtë zyrës noteriale). Subjekti në lidhje me këtë mjet nuk ka depozituar dokumentacion.

Komisioni ka konstatuar mospërputhje deklarimi për sa i përket çmimit të deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting” në shumën 1,900 euro + 60,000 doganë, kur deklarata e pushimit është pa çmim dhe vlera doganore është paguar nga shitësi D.S në shumën 34,308 lekë, duke i kërkuar subjektit shpjegime.

Subjekti ka dhënë shpjegimet si vijon: “*...çmimi i blerjes së mjetit “Skoda Octavia”, me targa AA *** KB, e blerë nga djali im, O Y, në datën 21.8.2014, është në vlerën 1,900 euro ashtu siç e kam deklaruar në vitin 2014...Nga ana e djalit tim O, janë paguar për shitësin D. S, 1900 euro plus shpenzimet e zhdoganimit të mjetit të cilat unë i kam deklaruar në shumën prej 60.000 lekë, por duke mos e detajuar këtë shifër veç e veç, në zhdoganim prej 34,308 lekësh dhe shpenzimet për regjistrim mjeti, si targim, siguracion etj.*”

Bashkëngjitur ndodhet një deklaratë noteriale e datës 5.4.2019³³ me deklarues D S, si dhe dokumentacionin tjetër mbështetës³⁴.

Subjekti, në lidhje me mosdeklarimin e burimit të krijimit për automjetin “Skoda Octavia”, me targa AA ***KB, ka dhënë shpjegime se ato kanë qenë të ardhurat vjetore të familjes.

³² Kontrata nr.*** rep, nr.*** kol, dt.15.09.2015 me shitës O. Y dhe blerës A.C me vlerën 1600 euro.

³³ Deklarata noteriale nr. *** datë 5.4.2019.

³⁴ Shkresa kthim përgjigje nga DRSHTRR-ja Durrës nr. ***, datë 3.4.2019, ku përfshihen dosja e mjetit nr. DR*** për mjetin AA ***KB; kontratë shitblerjeje mjeti nr. ***, datë 15.9.2015 dhe deklarata doganore e datës 5.9.2014; certifikatë shitje (disponimi) automjeti në gjuhën franceze e datës 21.08.2014; certifikate pronësie franceze, konfirmuar këto me vulën e doganës Durrës; vërtetim të njësishë me origjinalin nr. *** rep, datë 05.09.2014.

❖ Konkluzion

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRR-ja, si dhe deklarimet e subjektit në lidhje me mospërputhjen e çmimit të deklaruar, i vlerësoi ato të plota dhe bindëse.

Në lidhje me burimin e krijimit të këtij mjete, deklaruar nga subjekti se ai është blerë me të ardhurat vjetore të familjes (pra të vitit 2014 kur është blerë mjete), rezulton se burimi i krijimit (të ardhurat vjetore të familjes) në shumën 1,900 euro + 60,000 lekë doganë nuk justifikohet, pasi nga analiza financiare deri në momentin e krijimit të kësaj pasurie nuk rezulton të ketë të ardhura të mjaftueshme.

c) Automjeti tip “Opel Zafira”, me targa DR * E (ndryshuar me taraga DR ***F), e vitit 2003, në pronësi të Ardian dhe M Y.**

Në deklaratën periodike të vitit 2006, subjekti ka deklaruar: *“Blerë automjeti tip “Opel” i regjistruar me targa DR *** E me faturë tatimore. Vlera 5800 euro”*.

Subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi.

Në deklaratën periodike të vitit 2014, subjekti ka deklaruar: *“Shitur mjete “Opel Zafira” me targa DR *** F, me kontratën e shitjes³⁵ nr***, datë 8.1.2013, në shumën 3,000 euro”*.

Nga dokumentacioni i përcjellë rezulton fatura shitjes e datës 20.10.2006 e lëshuar nga “E.C”, Itali, ku i shet këtë mjet në vlerën 5,800 euro, z. Ardian Ylli, dokumenti i zhdoganimit i datës 23.10.2006, ku pasqyrohet vlera e blerjes së mjetit në shumë 5,800 euro dhe dogana e paguar në vlerën 368,156 lekë duke referuar emrin Ardian Ylli.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit pasi referuar deklaratës periodike të vitit 2006 ka konstatuar se nga ana e tij në lidhje me mjetin “Opel Zafira” nuk është deklaruar shuma 368,156 lekë paguar si doganë, por është deklaruar vetëm vlera 5,800 euro e çmimit të blerjes.

Subjekti në përgjigje të tij ka shpjeguar: *“...është e vërtetë që nga ana ime në deklaratën periodike, është pasqyruar vetëm çmimi i blerjes së mjetit në shumën 5,800 euro dhe nuk është deklaruar pagesa e bërë nga unë për zhdoganimin e mjetit. Ky lapsus mendoj se ka të bëjë me shumë me një harresë nga ana ime, se sa me një mosdeklarim të qëllimshëm dhe për faktin se mjete është blerë në monedhë të huaj dhe veprimet e bëra nga unë për zhdoganimin kanë qenë në lekë”*

Në lidhje me mosdeklarimin e burimit të krijimit për mjetin “Opel Zafira” me targa DR *** E, subjekti ka shpjeguar: *“...mjete tip “Opel Zafira” është blerë nga ana ime në muajin tetor 2006 dhe për këtë mjet është paguar dhe detyrimi doganor po nga unë dhe burimi i krijimit, kanë qenë të ardhurat vjetore të akumuluar deri në atë moment”*.

❖ Konkluzion

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRR-ja, si dhe shpjegimet e bëra nga subjekti, i vlerëson ato të plota dhe bindëse.

d) Automjeti tip “Renault”, me targa DR * D, në emër të Ardian Ylli**

Në deklaratën periodike të vitit 2003 subjekti ka deklaruar: Automjet tip “Renault” me vlerë 650,000 lekë. Burim krijimi: nga kursimet.

³⁵ Kontrata e shitjes nr. *** , datë 8.1.2013

Në deklaratën periodike të vitit 2006, subjekti ka deklaruar: *“shitur automjeti tip ‘Renault’ në vlerën 5,700 USD me kontratë shitjeje nr. ***, datë 14.7.2006”*. Nuk është depozituar dokumentacion në lidhje me blerjen dhe shitjen e këtij mjeti.

DPSHTRR-ja ka përcjellë dosjen e mjetit nga ku rezulton se ky mjet i është shitur subjektit nga shtetasi F. L, në datën 29.10.2003 për çmimin 500,000 lekë (deklaruar se është paguar jashtë zyrës noteriale).

Subjekti më pas ia ka shitur këtë mjet në datën 14.7.2006 shtetases K D, me çmimin 5,700 USD, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Komisioni ka konstatuar mospërputhje deklarimi për sa i përket çmimit të blerjes, deklaruar blerë 650,000 lekë në vitin 2003 dhe pasqyruar në kontratën e shitblerjes se është blerë 500,000 lekë, dhe për këtë shkak i drejtohet subjektit me pyetësin nr. 3 në të cilin i kërkon shpjegime në lidhje me këtë konstatim.

Subjekti në përgjigje të tij ka deklaruar :*“Deklarata e bërë nga ana ime në vitin 2003, në lidhje me vlerën prej 650.000 lekësh për blerjen e mjetit, është tërësisht e saktë, pasi këtë shumë unë e kam paguar jashtë zyrës noteriale, shitësit të këtij mjeti shtetasit F. L, me të cilin kemi njohje familjare. Mendoj se kemi të bëjmë me një lapsus në pasqyrimin e vlerës në kontratën e shitblerjes, shpjegimi dhe qëndrimi im për deklarimin e vlerës së blerjes në shumën 650.000 lekë është i saktë dhe mendoj se lapsusi është bërë në vlerën e shënuar në kontratën e shitblerjes, të cilës nuk i kemi kushtuar vëmendjen e duhur por e kemi nënshkruar atë”*.

Subjekti ka bashkangjitur dhe dokumentacionin përkatës mbështetës.³⁶

❖ **Konkluzion**

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e depozituar nga DPSHTRR-ja, si dhe deklaratimet e subjektit, i vlerëson ato bindëse dhe të mjaftueshme.

e) Automjeti tip “Renault” në emër të Ardian Ylli

Subjekti, në deklaratën periodike të viti 2006, ka deklaruar: *“blerë automjet “Renault” me vlerë 500,000 lekë sipas kontratës³⁷ së datës 15.6.2006”*. Nuk është deklaruar burim krijimi.

Subjekti, në deklaratën periodike të vitit 2006, ka deklaruar: *“shitur automjeti “Renault” në vlerën 900,000 lekë me kontratën nr. ***, datë 21.9.2006”*.

Nuk është depozituar dokumentacion në lidhje me blerjen dhe me shitjen e këtij mjeti.

DPSHTRR-ja ka dërguar dosjen e këtij mjeti nga ku rezulton se ky mjet është blerë në Itali nga shtetasi A L me banim në Romë për çmimin 3800 euro ne datë 26.5.2006.

Shtetasi A L për këtë mjet ka paguar vlerën e doganës në shumën 254,341 lekë, në datën 13.6.2006 dhe në total për këtë automjet ka paguar shumën 468,540 lekë + 254,341 lekë = 722,881 lekë.

Shtetasi A L në datën 15.6.2006 ia ka shitur këtë mjet shtetasit Ardian Ylli me çmimin 500,000 lekë.

³⁶ Kontratën e shitblerjes nr.***, datë 29.10.2003; deklaratë doganore e datës 18.10.2003; kontratë shitje automjeti nr. ***, datë 14.7.2006; deklaratë noteriale nr. ***, datë 6.4.2019, e shtetasit F.L.

³⁷ Kontrata nr.***, datë 15.6.2006.

Subjekti Ardian Ylli, automjetin tip “Renault Megane”, ia shet këtë mjet në datën 21.9.2006 (vetëm pas 3 muajsh) shtetases A.B me çmimin 900,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Nisur nga kjo diferencë e konsiderueshme e çmimit të blerjes me atë të shitjes, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime në lidhje me këtë diferencë në shitblerje (blerë 500,000 lekë dhe shitur pas 3 muajsh 900,000 lekë).

Subjekti në përgjigje të tij ka shpjeguar se: *“...vlera prej 500,000 lekësh ka të bëjë vetëm me vlerën e blerjes së mjetit pa u përfshirë vlera e zhdoganimit. Po të vërehet, edhe në deklaratën periodike është cilësuar nga ana ime se vlera prej 500,000 lekë është “vlera e cituar pa zhdoganim. Në këtë kuptim çmimi se deklarimi im në vitin 2006 dhe vlera e kontratës së shitblerjes përputhen pasi vlera në kontratë përfaqëson vetëm vlerën e mjetit pa zhdoganim, pavarësisht se shitësi e kishte paguar dy ditë më parë doganën. Kjo për faktin se unë dhe z. A.L, për shkak dhe të miqësisë që ka më të afërmit e mi dhe me mua, ramë dakord që në momentin e hartimit të kontratës ti jepja atij vetëm 500.000 lekë sa ishte afërsisht çmimi i mjetit. Kjo dakordësi u bë që të më jepte kohë të shisja mjetin tip “Renault” me targa DR *** D dhe më pas ti jepja edhe diferencën. Dhe në fakt diferenca prej afro 230.000 lekë i është paguar z. L nga ana ime pas shitjes së mjetit ‘Renault’ DR *** D, rreth muajit korrik të atij viti”.*

Në lidhje me shitjen e mjetit në vlerën 900,000 lekë, subjekti ka shpjeguar: *“Vlera në total e këtij mjeti, shkoi në shumën e rreth 750.000 lekëve, duke përfshirë edhe shpenzimet për regjistrimin e mjetit, shpenzimet noteriale dhe hedhjen e tij në qarkullim konform rregullave të qarkullimit rrugor. Mendoj se shitja e bërë në vlerën e deklaruar nga unë (900.000) lekë, duke shtuar edhe shpenzime për zëvendësim pjesësh xhenerike etj., është brenda normës së një fitimi sipas rregullave të tregut. Shtojmë këtu faktin se mjeti në momentin e shitjes, ishte në gjendje shumë të mirë, i plotësuar me gjithë dokumentacionin përkatës, si taksat e qarkullimit dhe siguracionin vjetor, të sapo paguara të cilat bëjnë që vlera e shitjes të ishte brenda logjikës së tregut.”*

Subjekti si dokument mbështetës i shpjegimeve të tij ka depozituar dhe deklaratën noteriale³⁸ të datës 6.4.2019.

❖ Konkluzion

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRR-ja, si dhe deklaratimet e subjektit, i vlerëson ato bindëse dhe të mjaftueshme.

f) Automjeti “Fiat Punto”, me targa DR * E, i vitit 1998, në emër të Ardian dhe M. Y.**

Në deklaratën periodike të vitit 2008 subjekti ka deklaruar: *“Blerë automjet, tip “Fiat Punto” me targa DR *** E, viti 1998 në bashkëpronësi me bashkëshorten në vlerën 250,000 lekë (përfshirë dhe dogana”)*. Nuk është deklaruar burim krijimi.

Në deklaratën periodike të vitit 2009, subjekti ka deklaruar: *“Shitur automjeti tip “Fiat Punto” me targa DR *** E, viti 1998 në bashkëpronësi me bashkëshorten në vlerën 370,000 lekë”.*

Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime në lidhje me mungesën e dokumentacionin të blerjes dhe shitjes së këtij mjeti, si dhe në lidhje me diferencën prej 120,000 lekë të çmimit të shitjes shitur më tepër nga subjekti pas një viti.

³⁸ Deklarata noteriale nr.***, datë 6.4.2019.

Subjekti në deklarimet e tij ka dhënë shpjegime si vijon: “Ky mjet ka ardhur nga Italia, me certifikate pronësie të firmës “C. C”, me nr. ***U, me faturën nr. ***, datë 15.4.2008, në vlerën 700 euro, në emrin tim. Sipas deklaratës doganore të datës 16.4.2008, vlera e makinës është 105,764 lekë. Vlera doganore sipas kësaj deklarate është në vlerën 119.341 lekë. Në total vlera e kësaj makine së bashku me vlerën doganore ka shkuar në 225,105 lekë. Në deklaratën periodike të vitit 2008 unë kam pasqyruar vlerën totale 250,000 lekë, ku janë përfshirë edhe shpenzimet e tjera regjistrim, targim etj. Për sa i përket diferencës ndërmjet blerjes në vitin 2008 dhe shitjes në vitin 2009, sqaroj se mjetit tip “Fiat Punto”, gjatë vitit të cilin ne e kemi poseduar, kryesisht bashkëshortja, si pasojë e disa shërbimeve të kryera në mjet, në momentin e shitjes gjendja e tij ishte shumë e mirë, dhe si rrjedhojë ajo makinë u shit në atë vlerë me vullnetin e plotë të palëve, të cilën e kam deklaruar në deklaratën periodike.

Subjekti ka depozituar dokumentacion mbështetës.³⁹

Në lidhje me burimin e krijimit për blerjen e këtij mjeti keni dhënë shpjegime: “ Mjeti është blerë me të ardhurat familjare të vitit, përfshirë dhe të ardhurat e pensionit te babait tim ndër vite...Duhet të shpjegoj gjithashtu, se unë në deklarimet periodike, nuk i kam pasqyruar si të ardhura pensionin e babait tim, pasi detyrimi ligjor ishte të deklaroja periodikisht për pjesëtarët që figuronin në certifikatën time familjare.”

❖ Konkluzion

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e depozituar nga subjekti në lidhje me mjetin “Fiat Punto”, si dhe deklarimet e subjektit i gjen ato bindëse dhe të mjaftueshme.

g) Në lidhje me mosdeklarimin e dy kredive të marra nga bashkëshortja e subjektit në vitin 2004 në shumën 200,000 lekë dhe në vitin 2009 në shumën 300,000 lekë.

“Fondi Besa” ka konfirmuar se në emër të shtetasës M Y rezulton se janë marrë dy kredi, një në datën 28.1.2004, në shumën 200,000 lekë, dhe një në datën 11.6.2009 në shumën 300,000 lekë.

Këto dy kredi nuk rezultojnë të deklaruara në deklaratat periodike të vitit 2004 dhe 2009 as nga subjekti dhe as nga bashkëshortja e tij.

Komisioni nisur nga ky mosdeklarim i ka kërkuar shpjegime subjektit.

Subjekti në përgjigje të tij ka deklaruar: “Mosdeklarimi nga ana ime për këto dy kredi, ka të bëjë thjesht me një harresë dhe mungesë vëmendje nga ana ime apo dhe e bashkëshortes, duke patur parasysh se për kredinë e parë ishin fillimet e deklarimeve periodike dhe për kredinë tjetër të vitit 2009 edhe kjo është një harresë nga ana ime gjithashtu, pasi nuk kisha asnjë arsye pse mos ti deklaroja. Por, gjithsesi, pavarësisht faktit se këto kredi janë në vlera të vogla, mosdeklarimi i këtyre dy kredive nuk ka qenë i qëllimshëm nga ana ime për fshehjen e të ardhurave”.

Komisioni ka kërkuar që subjekti të japë sqarime në lidhje me destinacionin e përdorimit të kredisë në vlerën 200,000 lekë.

³⁹ Shkresa kthim përgjigje nga DRSHTRR-ja Durrës nr. ***, datë 3.4.2019; dosja e mjetit nr. *** me targa DR ***E; leje qarkullimi me nr. DR***; certifikatë pronësie të shoqërisë “C. C” me nr. ***U, fatura nr. ***, datë 15.4.2008; deklaratë doganore e datës 16.4.2008; urdhër çlirim për pagesën e doganës në datën 16.4.2008; kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 31.1.2009; prokurë e posaçme për të përfaqësuarit Ardian dhe M.Y për shtetasin E. R; certifikate pronësie e mjetit rrugor; kopje e faqes 3 të deklaratës periodike të vitit 2008.

Subjekti në përgjigje të tij ka deklaruar: “... fakti që biznesi “Butik”, që ka lidhje me NIPT-in K***B nuk u realizua si aktivitet, shuma e marrë nga kjo kredi u shfrytëzua për nevoja të ndryshme familjare.

Subjekti i rivlerësimit, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka theksuar ndër të tjera se: “...përfundimisht lidhur me këto kredi, mendoj se nga ana juaj duhet të merret në konsideratë fakti që janë harresa, por nuk ka pasur për qëllim fshehjen e tyre, që në vetevete përbëjnë në fund të fundit një burim të ligjshëm financimi që duke u fshehur vetëm ndikon negativisht në analizën/situatën time financiare”.

Subjekti ka depozitur dhe shkresën e “Fondit Besa”⁴⁰ e cila në përgjigje të saj ka theksuar se për shkak të kohës që ka kaluar, mbi 5 vjet, nuk disponon dosjen e aplikimit të kredisë.

❖ Konkluzion

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e depozituar nga “Fondi Besa” dhe shpjegimet e subjektit, konstatoi se subjekti nuk i ka deklaruar ato në deklaratën periodike të pasurisë në vitin kur ato janë marrë, gjendjen e këtyre kredive ndër vite, si dhe mbylljen e tyre respektivisht në vitet 2005 dhe 2012. Për rrjedhojë, Komisioni arrin në përfundimin se kemi të bëjmë me deklaram të pamjaftueshëm të subjektit në lidhje me këto dy kredi.

12. Analiza financiare

Komisioni, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përgatiti analizën financiare mbështetur në të dhënat, në deklaramet periodike vjetore në ILDKPKI, në deklaratën “Vetting”, në informacionet e ardhura nga institucionet përkatëse dhe në deklaramet e vetë subjektit. Z. Ardian Ylli, ka qenë subjekt deklarami pa ndërprerje që prej vitit 2003.

Të ardhurat

Në këtë kategori janë përfshirë të gjitha të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe anëtarëve të tjerë të familjes nga pagat, fitimet neto nga biznesi, të ardhurat nga pensioni i babait, nga interesat bankare, si dhe të ardhura nga shitja e mjeteve. Të ardhurat e deklaruara nga subjekti janë vërtetuar me dokumentacionin nga institucionet në të cilët kanë qenë të punësuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore, si dhe bankat.

Për të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit janë marrë në analizë vlerat referuar vërtetimit nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për periudhën maj 1998 - shtator 2013 dhe 14 nëntor 2016 e në vazhdim; vërtetimit nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me nr. *** prot., datë 11.1.2017, për periudhën 1 shtator 2013 - 13 nëntor 2016,

Për të ardhurat nga pagat e bashkëshortes janë marrë në analizë vlerat referuar vërtetimit nga Drejtoria Rajonale Arsimore Durrës për periudhën 17 shkurt 2003 – 16 gusht 2004, 15 janar 2011 – janar 2014; vërtetim i Bibliotekës Publike Durrës me nr. ** prot., datë 10.1.2017, për periudhën 16 janar 2014 – dhjetor 2016. Për periudhën prill 2006 deri në shtator 2010, znj. M. Y ka ushtruar aktivitet privat si person fizik dhe nuk është trajtuar me pagë, por ka përfutuar të ardhura nga

⁴⁰ Shkresa e “Fondit Besa” nr. *** prot., datë 1.7.2019.

aktiviteti. Gjatë kësaj periudhe nuk rezulton që ajo të ketë përfituar të ardhura nga paga nga ndonjë punëdhënës.

Për të ardhurat nga pensioni i babait të subjektit – janë marrë në analizë vlerat referuar vërtetimit të ISSH-së Drejtoria Rajonale Durrës⁴¹ për pensionin e pleqërisë dhe vërtetimit⁴² për pensionin suplementar.

Për të ardhurat nga paga e djalit të subjektit R. Y – janë marrë në analizë vlerat referuar vërtetimi të Drejtorisë së Përgjithshëm të Shërbimit të Provës⁴³ me nr. *** prot., datë 18.10.2016 dhe për muajt tetor – dhjetor 2016 pagat e kaluara në bankë.

Për të ardhurat nga aktiviteti – janë marrë në analizë vlerat sipas shkresës së Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës drejtuar ILDKPKI-së, të nxjerra këto për vlerën neto nga deklaratat e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël/ tatim i thjeshtuar mbi fitimin për vitet. Për vitin 2006 i referohemi shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës⁴⁴ në datën 23.5.2019 drejtuar Komisionit. Për vitin 2007 i jemi referuar deklaratës parashikuese për qarkullimin vjetor të vitit 2008 dorëzuar në Bashkinë Durrës, në të cilin shënohet edhe qarkullimi faktik për vitin 2007 dhe deklaramentit të subjektit në pyetësorin nr. 4.

Për të ardhurat nga shitja e mjeteve janë marrë në analizë vlerat sipas kontratave të shitblerjeve⁴⁵.

Detyrime

Në këtë rubrikë janë pasqyruar shumat e marra hua referuar kontratave të huas lidhur me bankat e nivelit të dytë dhe institucionet financiare jo bankare dhe nxjerrjes së llogarive bankare.

Shpenzimet

Në këtë kategori janë hedhur të gjitha shpenzimet e deklaruara nga subjekti si shpenzime shkollimi, shpenzime pushimesh, shpenzime qiraje, shpenzime mobilimi etj., shpenzime jetese bazuar në të dhënat e marra nga ILDKPKI.

Shpenzimet jetike janë llogaritur referuar shkresës së ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë 4.3.2019, drejtuar Komisionit.

Për vitin 2007 konsumi për frymë është marrë sa viti 2006, pra, në vlerën 136,620 lekë, pasi në shkresën përcjellëse ai rezulton në vlerën 235,968 lekë, dukshëm jo i saktë për periudhën që referohet.

Për periudhën 2003 deri në janar 2012 shpenzimet jetike janë përlllogaritur për familje me 5 anëtarë, ndërsa nga shkurti i vitit 2012 dhe në vazhdim këto shpenzime janë përlllogaritur për familje me 4 anëtarë.

Shpenzimet e udhëtimit janë marrë në analizë sipas standardit të Komisionit për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit.

⁴¹ Shkresa nr. *** prot., datë 29.5.2019, ISSH-së Durrës.

⁴² Shkresa nr. *** prot., datë 29.5.2016.

⁴³ Shkresa nr. *** prot., datë 28.7.2007, e DRT Durrës, drejtuar ILDKPKI-së.

⁴⁴ Shkresa nr.*** prot., datë 23.5.2019, DRT-së Durrës.

⁴⁵ Kontrata e shitblerjes me nr. ***, datë 14.7.2006; kontratë shitblerje me nr. ***, datë 21.9.2006; kontratë shitblerje nr. ***, datë 31.1.2009; kontratë shitblerje nr. ***, datë 8.1.2014; kontratë nr.***, datë 15.9.2015.

Shpenzimet e shkollimit janë marrë në analizë sipas deklaramit të subjektit dhe dokumentacionit ligjor justifikues vënë në dispozicion Komisionit nga institucionet arsimore. Vërtetimi shkollës jo publike “F. Konica”⁴⁶ në lidhje me studimet parauniversitare të djalit O. Y, vërtetim i UET-së⁴⁷.

Shpenzimet për shlyerjen e kredisë (principal+interes) i referohen pagesave të kësteve të kredisë sipas nxjerrjes së llogarive bankare.

Shpenzimet e mobilimit janë marrë në analizë referuar deklaramit të subjektit për shumën totale prej 2,000,000 lekësh, të detajuar sipas viteve kur janë kryer, referuar deklarimeve të subjektit.

Shpenzimet nga llogaritë bankare për veshje dhe produkte estetike i referohen shpenzimeve faktike që subjekti ka kryer nga llogaritë e tij bankare. Në pyetësin nr. 5 subjekti është pyetur për natyrën e këtyre shpenzimeve, duke deklaruar se këto shpenzime janë kryer për veshje dhe produkte estetike, për nevojat e tij personale, për biznesin dhe blerje për llogari të miqve të tij.

Shpenzimet e telefonisë celulare i referohen transaksioneve bankare drejtuar shoqërisë “Vodafone”. Prokuroria e Përgjithshme në përgjigjen e saj drejtuar Komisionit sqaron se subjekti i rivlerësimit ka 4,000 lekë/muaj shpenzime telefonie të mbuluara nga institucioni të cilat i zbriten nga paga. Lidhur me këto shpenzime të identifikuar nga transaksionet bankare subjekti në pyetësin nr. 5 i pyetur nga Komisioni deklaroi se ato janë mbuluar nga vetë ai.

Pasuri

Në këtë kategori janë pasqyruar të gjitha pasuritë e paluajtshme, të luajtshme, si dhe likuiditetet e deklaruara në vitet përkatëse.

Likuiditetet (cash, bankë), janë regjistruar në një nënkategori të pasurisë “kursime pakësim/shtesa likuiditeti”. Në këtë kategori është pasqyruar ndryshimi e zërit likuiditete, pra, shtesën ose pakësimin e ndodhur gjatë vitit përkatës.

Të dhënat e deklaruara për gjendjet llogarive bankare në fund të vitit janë saktësuar duke marrë për bazë nxjerrjet e llogarive bankare të subjektit marrë nga bankat e nivelit të dytë.

Vlerat e **automjeteve**, pjesë e pasurisë së subjektit, janë shënuar referuar kontratave të shitblerjes duke shtuar në vlerën e këtyre pasurive edhe shpenzimet doganore sipas deklaramit të subjektit.

Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

⁴⁶ Vërtetimi i shkollës Konica nr*** prot. datë 26.03.2019

⁴⁷ Vërtetimi i universitetit UET, nr.*** prot., date 06.04.2019.

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Të ardhurat	1,002,019	1,257,048	1,071,098	3,501,101	2,368,132	1,665,023	2,548,221	2,189,127	2,508,646	2,217,815	2,104,137	3,291,544	4,180,323	4,870,448
Nga pagat dhe shpërblimet e subjekti	612,448	892,390	849,143	835,583	866,991	856,511	1,130,061	1,338,451	1,287,012	1,183,548	1,352,051	1,732,365	1,694,467	1,685,698
Nga pagat e bashkëshortes	221,040	173,402	0	0	0	0	0	0	488,398	520,041	572,086	680,917	678,060	718,418
Nga pagat e djalit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	457,932	487,575	593,055
Të ardhura nga aktiviteti privat	0	0	0	991,620	1,250,000	540,000	701,964	432,000	300,000	480,000	180,000	0	1,099,402	1,871,615
Të ardhura nga pensioni i babait	168,531	191,256	221,955	238,782	250,192	264,971	346,196	418,676	433,236	34,226	0	0	0	0
Të ardhura nga shitja e mjetit	0			1,433,930	0	0	370,000	0	0	0	0	420,330	220,240	0
Të ardhura nga interesat	0	0	0	1,185	949	3,541	0	0	0	0	0	0	579	1,662
Detyrime	0	200,000	0	950,000	6,740,950	300,000	800,000	0	0	0	0	5,500,000	0	0
Kredi Fondi Besa MY dt.28.01.2004, afat 1 vit, vlerë 200.000 për aktiv.		200,000												
Kredi Fondi Besa MY dt.23.03.2006, afat 3 vjet, vlerë 700.000 për aktiv.				700,000										
Kredi NBG MY dt.05.12.2006, afat 4 vjet, vlerë 250.000				250,000										
Kredi NBG MY dt.16.04.2007, 500.000 lekë, afat 5 vjet					500,000									
Kredi NBG MY dt.19.04.2007, 30.000 Euro për rikonstruksion banese					3,627,300									
Kredi NBG MY dt.03.12.2007, 15.000 Euro për rikonstruksion banese					1,813,650									
Kredi BKT MY 300.000 Lekë 31.01.2007-04.12.2007					300,000									
Kredi BKT AY 500.000 Lekë 07.08.2007					500,000									
Kredi Fondi Besa MY dt.10.03.2008 - 04.12.2008, vlerë 300.000						300,000								
Kredi Fondi Besa MY dt.18.06.2009 - 31.07.2009, vlerë 300.000							300,000							
Kredi RBAL 500.000 04.02.2009-08.07.2014 (shlyerje e parakohshme)							500,000							
Kredi ISPB 5.500.000 lekë												5,500,000		
Shpenzime	949,820	1,541,461	772,056	2,840,744	4,170,560	2,323,650	1,671,371	2,099,510	2,200,191	2,719,195	2,506,910	9,163,720	3,570,820	6,826,415
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - së	469,820	469,820	547,785	547,785	683,100	683,100	683,100	683,100	683,100	569,821	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime udhëtimi	0	179,971	189,937	479,968	492,104	482,875	94,647	505,962	461,645	894,208	559,438	969,561	496,917	1,268,833
Shpenzime tatim fitimi i thjeshtuar K31624518B		110,000												
Shpenzime shkollimi	0	0	0	0	0	0	0	27,762	67,660	117,944	118,042	288,187	258,094	223,196
Shpenzime për shlyerjen e kredisë (principal+interes)	0	191,670	34,334	258,900	2,100,240	1,064,666	873,370	861,388	909,884	805,210	712,103	6,129,531	517,856	3,056,945
Shpenzime mobilimi	480,000	590,000	0	580,000	350,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shpenzime nga logaritë bankare për veshje	0	0	0	20,314	214,260	56,899	0	0	77,902	258,868	420,979	485,152	573,473	530,921
Shpenzime nga logaritë bankare për veshje për të tretë										73,144	26,338	232,632	575,901	105,532
Shpenzime telefonie	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	105,914	178,664	237,098	457,026
Shpenzime qiraje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	240,000
Shpenzime për aktivitetin sipas kontratave të kredisë	0	0	0	950,000	300,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shpenzime kartë krediti (interesa dhe penalitete)	0	0	0	3,778	30,856	36,110	20,254	21,298	0	0	0	0	14,378	3,595
Pasuri	650,000	-10,266	-85,664	2,274,273	4,524,766	136,400	443,849	244,126	447,304	636,166	95,732	1,741,653	1,270,608	-2,180,293
Kursime (Pakësim/Shtesa likuiditeti)	0	-10,266	-85,664	438,639	292,916	-113,600	443,849	244,126	447,304	636,166	95,732	1,035,595	1,270,608	-2,180,293
Banese 3+1,L,4, Rr.Skenderbej, pall.405 Durres														
Autoveturë tip Renault DR 1000 D	650,000													
Autoveturë tip Renault DR 8999 D				750,000										
Autoveturë tip Opel DR 0001 F				1,085,633										
Rikonstruksion i banesës me sip.95 m2 + shtesë banese 38 m2					4,231,850									
Automjet tip FIAT PUNTO, DR 5100 E viti 1998						250,000								
Automjet tip Benz Mercedes OY, AA 001 LT												379,848		
Automjet tip SKODA Oktavia OY, AA 414 KB												326,209		
Të ardhura + detyrime - shpenzime - pasuri	-597,801	-74,147	384,706	-663,916	413,756	-495,027	1,233,001	-154,509	-138,850	-1,137,547	-498,505	-2,113,828	-661,105	224,326

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Të ardhurat	1,002,019	1,257,048	1,071,098	3,501,101	2,368,132	1,665,023	2,548,221	2,189,127	2,508,646	2,217,815	2,104,137	3,291,544	4,180,323	4,870,448
Detyrime	0	200,000	0	950,000	6,740,950	300,000	800,000	0	0	0	0	5,500,000	0	0
Shpenzime	949,820	1,541,461	772,056	2,840,744	4,170,560	2,323,650	1,671,371	2,099,510	2,200,191	2,719,195	2,506,910	9,163,720	3,570,820	6,826,415
Pasuri	650,000	-10,266	-85,664	2,274,273	4,524,766	136,400	443,849	244,126	447,304	636,166	95,732	1,741,653	1,270,608	-2,180,293
Të ardhura + detyrime - shpenzime - pasuri	-597,801	-74,147	384,706	-663,916	413,756	-495,027	1,233,001	-154,509	-138,850	-1,137,547	-498,505	-2,113,828	-661,105	224,326

Nga analiza financiare e përgatitur nga Komisioni për periudhën 2003-2016, rezultoi se për vitet 2003 – 2004, 2006, 2008, 2010 – 2015 ka një rezultat negativ në vlerën 6,535,235 lekë, e pa justifikuar me burime të ligjshme.

Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime të detajuara në lidhje me këta elementë të analizës financiare, si më poshtë vijon:

1. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se investimet e bëra në vitin 2003, konkretisht blerja e automjetit në datën 29.10.2003 për vlerën 650,000 lekë dhe shpenzimet e mobilimit të kryera deri në vitin 2003 në vlerën 480,000 lekë, nuk duhet të llogariten nga të ardhurat e vitit 2003, pasi këto shpenzime logjikisht janë përballuar nga kursimet e familjes të krijuara para vitit 2003 në shumën rreth 700,000 lekë nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, si dhe 300,000 lekë të kursyera nga babai i tij. Subjekti ka shpjeguar se shpenzimet e mobilimit të deklaruar për shumën 480,000 lekë deri në vitin 2003 janë kryer 300,000 para vitit 2003 dhe 180,00 lekë në vitin 2003.

Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit janë bindëse. Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mundësi financiare për të krijuar kursimet e pretenduara për periudhën para vitit 2003 me të ardhura të ligjshme. Komisioni pranoi pretendimet e subjektit, duke i përfshirë ato në analizën ekonomike.

2. Në lidhje me shpenzimet e mobilimit për vitet 2004 dhe 2005 subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nga Komisioni është konsideruar shuma e investimeve të kryera për mobilim në vlerën 590,000 lekë bazuar në deklarin e tij të të mëparshëm në pyetësor, megjithatë kjo shpërndarje nuk përfaqëson shumën e saktë sipas viteve, por një vlerësim të përafërt. Subjekti, duke vlerësuar analizën e kryer nga Komisioni, ka kërkuar shpërndarjen e investimit për mobilim përkatësisht në vlerën 500,000 lekë për vitin 2004 dhe vlerën 90,000 lekë për vitin 2005.

Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit pas rezultateve të hetimit nuk janë në harmoni me deklarin e tij në pyetësor dhe duket se ato vijnë për shkak të situatës financiare negative të vitit 2004. Këto pretendime nuk janë pranuar nga Komisioni.

3. Subjekti ka deklaruar se babai i tij ka qenë pjesë e familjes dhe kanë jetuar së bashku. Babai i subjektit ka përfituar pension pleqërie, si dhe pension suplementar, dhe të ardhurat nga pensioni nga viti 2003 deri në vitin 2012 të cilat i kursente duke i vënë në dispozicion të ekonomisë së përbashkët familjare herë pas here, prandaj këto të ardhura nuk duhen konsideruar si kontribut i përvitshëm, por si një fond kursimi i përdorur ndër vite.

Subjekti pretendon se të ardhurat e babait ndër vite dhe ato të kursyera janë të pasqyruara në tabelën, si më poshtë:

Viti	Para vitit 2003	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	Totali
Të ardhura nga pensioni i babait	300,000	168,531	191,256	221,955	238,782	250,192	264,971	346,196	418,676	433,236	34,226			2,868,021
Të ardhura të shpenzuara	0	0	191,256	0	0	0	100,000	0	0	483,236	34,226	500,000	1,559,303	2,868,021
Të ardhura të kursyera	300,000	168,531	0	221,955	238,782	250,192	164,971	346,196	418,676	-50,000	0	-500,000	-1,559,303	0
Kursime të akumuluar	300,000	468,531	468,531	690,486	929,268	1,179,460	1,344,431	1,690,627	2,109,303	2,059,303	2,059,303	1,559,303	0	0

Subjekti ka pretenduar se pas vdekjes së babait ka poseduar kursimet e tij në vlerën 2,059,303 lekë, të cilat i ka përdorur përkatësisht në vitin 2013 vlerën prej 500,000 lekësh dhe në vitin 2014 vlerën prej 1,559,303 lekësh.

Në vlerësim të shpjegimeve të subjektit, si dhe provave të paraqitura, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk i ka deklaruar këto kursime në vite, me shpjegimin se nuk ka pasur detyrim ligjor për t'i deklaruar.

Subjekti ka shpjeguar se në muajin dhjetor të vitit 2011 babai ka qenë i sëmurë dhe u ka dhënë të gjitha kursimet e veta. Ndërkohë, subjekti nuk i ka deklaruar as si gjendje *cash* në banesë dhe as si burim financimi shumat e pretenduara në deklaratimet periodike të viteve 2011, 2012, 2013 dhe 2014. Po ashtu, i paprovuar mbetet edhe pretendimi i subjektit se në disa vite të ardhurat nga pensioni janë përdorur për të përballuar shpenzimet familjare dhe në disa vite ato janë kursyer sipas tabelës përkatëse.

Lidhur me pretendimet e subjektit mbi të ardhura nga pensioni i babait të trajtuara më lart Komisioni i ka pranuar ato si të ardhura, duke i përfshirë në analizën financiare si të ardhura vjetore. Pretendimet e subjektit se në disa vite të ardhurat nga pensioni janë kursyer dhe janë administruar prej tij në vitin 2011 dhe më pas përdorur, përkatësisht në vitet 2013 dhe 2014, nuk u pranuan nga Komisioni, pasi ato nuk u provuan në asnjë formë nga subjekti i rivlerësimit. Shpjegimet e tij nuk u dukën bindëse për Komisionin, pasi sqarimet e dhëna nga subjekti në rezultatet e hetimit i referohen situatave negative financiare të rezultuara nga analiza ekonomike dhe nuk u provuan me ndonjë dokument (librezë kursimi, depozitë, deklaratime, etj).

4. Të ardhura nga kontributet e të afërmeve dhe miqve në formë respekti sipas zakonit shqiptar për ceremoninë mortore të të ndjerit, babait të subjektit, në shumën 750,000 lekë për vitin 2012. Subjekti deklaroi se këto të ardhura nuk janë deklaruar si zë më vete të ardhurash për shkak të natyrës së krijimit të tyre, por vetëm si shtesë kursimesh në vitin 2012 dhe 2013, respektivisht në shumën 500,000 dhe 240,000 lekë. Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit deklaratat materiale të familjarëve dhe miqve të tij.

Babai i subjektit ka ndërruar jetë në muajin janar të vitit 2012 dhe shpjegimet e subjektit lidhur me këto të ardhura, të cilat reflektojnë burimin e kursimeve të deklaruara si gjendje *cash* në banesë në fund të vitit 2012 dhe 2013, nuk u dukën bindëse për Komisionin, pasi ato janë shpërndarë referuar situatës financiare negative nga analiza ekonomike. Po ashtu, Komisioni ka vlerësuar se edhe nëse i pranon si të ardhura mbështetur në bindjen e brendshme, shpërndarja e tyre në vitin 2013 mbetet e pajustificuar.

5. Në lidhje me të ardhurat nga biznesi i bashkëshortes për vitin 2008 subjekti i rivlerësimit argumentoi se analiza duhet të marrë në konsideratë shumën *neto* prej 581,250 lekësh, kundrejt shumës 540,000 lekë të llogaritur nga Komisioni. Shuma prej 540,000 lekësh përfaqëson të ardhurat *neto*, por megjithatë shuma e tatimit prej 60,000 lekësh është paguar 18,750 lekë në vitin 2008 dhe 41,250 lekë në vitin 2009, duke rezultuar kështu për vitin 2008 me shumën 41,250 lekë më shumë fitim, në një total prej 581,250 lekësh dhe për vitin 2009 me 41,250 lekë më pak fitim, në një total prej 660,714 lekësh. Subjekti vendosi në dispozicion mandatpagesat e kësteve të tatimit për vitet 2008 dhe 2009.

Komisioni vlerëson se shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit janë bindëse dhe të plota dhe për këto arsye ka marrë në konsideratë pretendimin e subjektit.

6. Në lidhje me shpenzimet e shkollimit të djalit R.Y për periudhën 2009 – 2014 subjekti i rivlerësimit argumentoi se për të gjitha vitet e studimit pagesa në total në vlerën 1,000 euro është bërë e gjitha në vitin 2009 dhe jo e ndarë ndër vite sipas analizës së Komisionit. Subjekti ka sjellë si dokumentacion provues vërtetimin e datës 27.6.2019 në të cilin konfirmohet fakti i pagesës së vlerës 1,000 euro në vitin 2009 dhe “lista e studentëve dhe pagesave për vitet 2009 - 2010; 2010-2011; 2011-2012; 2013-2014”, në të cilat vërtetohet përfitimi i bursës për vitet e tjera të studimit.

Komisioni vlerëson se shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit janë bindëse dhe të mjaftueshme dhe për këto arsye Komisioni ka marrë në konsideratë pretendimin e subjektit.

7. Në lidhje me saktësimin e përdorimit të fondeve të kredisë, subjekti ka sqaruar se ka pasur raste kur një pjesë e fondeve të marra në formë kredie janë përdorur prej tij në vitin pasardhës. Subjekti shpjegon se shuma 15,000 euro e marrë si kredi në dhjetor të vitit 2007, nuk është shpenzuar tërësisht brenda muajit dhjetor 2007, por një pjesë e kësaj kredie në vlerën 450,000 lekë është shpenzuar gjatë vitit 2008. Gjithashtu, në vitin 2009 shuma prej 500,000 lekësh nga kreditë e marra nuk u përdor në vitin 2009, por në vitin pasardhës. Shuma e kredisë së papërdorur nuk është deklaruar si kursim parash, për faktin se janë konsideruar si fonde huaje dhe jo para të vetë subjektit.

Kjo kërkesë e subjektit nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni për sa kohë nuk rezulton e deklaruar si kursim në bankë ose gjendje *cash* në vitin përkatës.

8. Në lidhje me kreditë e marra për aktivitetin e bashkëshortes, znj. M. Y, në shumën 700,000 lekë, datë 23.03.2006 nga Fondi Besa; shumën 250,000 lekë, datë 5.12.2006 në “NBG” dhe shumën 300,000 lekë, datë 31.1.2007, në “BKT”, subjekti shpjegon se zëri “*shpenzime për aktivitet sipas kontratës së kredisë*”, nuk duhet marrë në analizë, pasi lidhet me shpenzimet e biznesit, të cilat janë marrë në konsideratë në kostot e biznesit përpara se të deklarohen të ardhurat *neto*.

Subjekti ka konfirmuar se shuma prej 700,000 lekësh është konsumuar për kryerjen e disa investimeve, blerjen e pajisjeve, apo produkteve të cilat do të shërbenin për zhvillimin e aktivitetit. Shuma prej 700,000 lekësh e shpenzuar e gjitha për investim në biznes nuk është e pasqyruar në shpenzimet vjetore të biznesit për vitin 2006, prej 184,773 lekë.

Komisioni vlerëson se shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk janë bindëse. Përlllogaritja e kësaj shume në analizën e vitit 2006, si një zë shpenzimi i veçantë nga Komisioni, paraqet situatën financiare me vërtetësi dhe saktësi.

8.1 Po kështu, edhe shuma prej 250.000 lekësh marrë në “NBG” në vitin 2006 dhe shuma 300,000 lekë marrë në “BKT” në vitin 2007 janë përdorur për nevoja të biznesit. Subjekti ka deklaruar gjithashtu se në kushtet kur aktiviteti privat si person fizik nuk është i ndarë nga individit si pjesë e familjes, nuk përjashtohet mundësia që një tepricë nga këto kredi të marra të jenë përdorur për nevojat familjare. Për vitin 2006 subjekti ka deklaruar shpenzime të aktivitetit

shumën prej 184,773 lekësh, ndërsa për vitin 2007 ka deklaruar shpenzime të aktivitetit shumën prej 252,656 lekësh.

Komisioni vlerëson se shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit janë bindëse. Në analizën financiare të Komisionit është marrë si e ardhur fitimi *neto* i aktivitetit privat. Në këto kushte shuma e kredisë së shpenzuar është pasqyruar te shpenzimet e aktivitetit dhe për këtë arsye është përfshirë një herë në analizën financiare nëpërmjet të ardhurave neto nga biznesi.

9. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar disa nga përfundimet e Komisionit në lidhje me shpenzimet e llogaritura për udhëtimet, duke shpjeguar se ai ka qenë shumë i kujdesshëm për të bërë prenotimet e biletave shumë kohë përpara udhëtimeve dhe akomodimit në hotele, apo duke shfrytëzuar ofertat e ndryshme të ulëta sezonale, për të cilat nuk ka dokumentacion justifikues referuar konfirmimeve të siguruara nga agjenci të ndryshme udhëtimi. Subjekti ka shpjeguar se në një pjesë të konsiderueshme të udhëtimeve ata kanë qëndruar te miq dhe të afërm, dhe se shpenzimet e qëndrimit janë mbuluar nga mikpritësit për shkak të lidhjeve të ngushta familjare dhe miqësore. Për këto udhëtime subjekti ka sjellë deklaratat noteriale nga miqtë dhe të afërmit në SHBA, Kanada, Itali, Gjermani, Greqi, Turqi dhe Francë.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, arrin në konkluzionin se ai nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për shpenzimet e udhëtimit të kryera prej tij dhe familjarët, dhe se vlerat referuese të përdorura nga Komisioni në analizën ekonomike janë relativisht të ulëta. Komisioni ka marrë në konsideratë qëndrimin te të afërmit, në rastet e dokumentuara nga subjekti, duke mos llogaritur kosto për akomodimin.

9.1 Në lidhje me disa prej udhëtimeve në të cilat subjekti deklaroi se ato janë kryer nga bashkëshortja e tij për qëllime biznesi dhe për këtë arsye shpenzimet për këto udhëtime nuk duhen marrë në konsideratë në analizë, pasi janë të pasqyruara në formularët e deklaramit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Subjekti e ka mbështetur deklaramin e tij në certifikatat e trajnimeve profesionale të marra nga bashkëshortja e tij, si dhe në formularët e deklaramit të tatimit të thjeshtuar.

Shpjegimet e subjektit në lidhje me shpenzimet e udhëtimit të kryera nga bashkëshortja e tij, për qëllime të biznesit, të dokumentuara, janë marrë në konsideratë nga Komisioni.

10. Për shpenzimet e kryera nga llogaritë bankare gjatë udhëtimeve të kryera jashtë shtetit subjekti ka shpjeguar se disa prej shpenzimeve kanë qenë për miqtë e ngushtë. Ai ka deklaruar se këto shpenzime janë *rimbursuar* tërësisht prej tyre dhe për këtë arsye shuma e këtyre shpenzimeve nuk duhet të rëndojë bilancin e pasurisë familjare. Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit deklaratat noteriale të personave për të cilët janë kryer këto shpenzime.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, arrin në konkluzionin se subjekti ka arritur të dokumentojë shpenzimet nga llogaritë bankare për të tretët, duke i marrë në konsideratë kërkesat dhe duke i reflektuar në analizën financiare.

10.1 Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se disa prej shpenzimeve të kryera nga llogaritë bankare janë bërë për qëllime të biznesit, dhe si të tilla kanë rënduar një herë shpenzimet e aktivitetit,

duke u zbritur nga të ardhurat e realizuara prej tij. Duke u vendosur si element shpenzimi në këtë analizë, bilanci i llogarisë rëndohet dy herë për të njëjtin shpenzim. Në cilësinë e dokumentacionit justifikues, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit deklaratat vjetore të tatimit të thjeshtuar për vitet përkatëse.

Komisioni çmon se subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion provues për të vërtetuar se ato shpenzime ishin për biznesin dhe jo për përdorim personal, për rrjedhojë, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë këtë kërkesë të subjektit.

11. Në lidhje me shumën e pagimit të kësteve të kredisë për vitin 2014, subjekti ka shpjeguar se në bazë të dokumenteve të bankës rezulton që shuma e kësteve të kredisë e paguar për vitin 2014 është 5,856,153 lekë dhe jo 6,129,531 lekë, sa është llogaritur nga Komisioni.

Komisioni ka verifikuar shumën e kësteve të paguara për vitin 2014, referuar dokumentacionit bankar, duke rezultuar që shuma e llogaritur prej tij është e saktë dhe për rrjedhojë ky pretendim i subjektit nuk u mor në konsideratë.

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Të ardhurat	1,002,019	1,257,048	1,071,098	3,501,101	2,368,132	1,706,273	2,506,971	2,189,127	2,508,646	2,217,815	2,104,137	3,291,544	4,180,323	4,870,448
Nga pagat dhe shpërblimet e subjekti	612,448	892,390	849,143	835,583	866,991	856,511	1,130,061	1,338,451	1,287,012	1,183,548	1,352,051	1,732,365	1,694,467	1,685,698
Nga pagat e bashkëshortes	221,040	173,402	-	-	-	-	-	-	488,398	520,041	572,086	680,917	678,060	718,418
Nga pagat e djalit	-	-	-	-	-	-	-	-	0	0	0	457,932	487,575	593,055
Të ardhura nga aktiviteti privat	-	-	-	991,620	1,250,000	581,250	660,714	432,000	300,000	480,000	180,000	0	1,099,402	1,871,615
Të ardhura nga pensioni i babait	168,531	191,256	221,955	238,782	250,192	264,971	346,196	418,676	433,236	34,226	0	0	0	0
Të ardhura nga shitja e mjetit	-	-	-	1,433,930	0	0	370,000	0	0	0	0	420,330	220,240	0
Të ardhura nga interesat	-	-	-	1,185	949	3,541	0	0	0	0	0	0	579	1,662
Detyrime	0	200,000	0	950,000	6,740,950	300,000	800,000	0	0	0	0	5,500,000	0	0
Kredi Fondi Besa MY dt.28.01.2004, afat 1 vit, vlerë 200.000 për aktivitet	-	200,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kredi Fondi Besa MY dt.23.03.2006, afat 3 vjet, vlerë 700.000 për aktivitet	-	-	-	700,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kredi NBG MY dt.05.12.2006, afat 4 vjet, vlerë 250.000	-	-	-	250,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kredi NBG MY dt.16.04.2007, 500.000 lekë, afat 5 vjet	-	-	-	-	500,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kredi NBG MY dt.19.04.2007, 30.000 Euro për rikonstruksion banese	-	-	-	-	3,627,300	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kredi NBG MY dt.03.12.2007, 15.000 Euro për rikonstruksion banese	-	-	-	-	1,813,650	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kredi BKT MY 300.000 Lekë 31.01.2007-04.12.2007	-	-	-	-	300,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kredi BKT AY 500.000 Lekë 07.08.2007	-	-	-	-	500,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kredi Fondi Besa MY dt.10.03.2008 - 04.12.2008, vlerë 300.000	-	-	-	-	-	300,000	-	-	-	-	-	-	-	-
Kredi Fondi Besa MY dt.18.06.2009 - 31.07.2009, vlerë 300.000	-	-	-	-	-	-	300,000	-	-	-	-	-	-	-
Kredi RBAL 500.000 04.02.2009-08.07.2014 (shlyerje e parakohshme)	-	-	-	-	-	-	500,000	-	-	-	-	-	-	-
Kredi ISPB 5.500.000 lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	5,500,000	-	-
Shpenzime	649,820	1,541,461	772,056	2,590,744	3,870,560	2,221,409	1,808,541	2,031,494	2,096,196	2,540,109	2,427,292	8,819,140	2,999,324	6,685,984
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI -së	469,820	469,820	547,785	547,785	683,100	683,100	683,100	683,100	683,100	569,821	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime udhëtimi	-	179,971	189,937	479,968	492,104	380,634	94,647	465,708	385,580	816,244	534,200	885,635	501,321	1,233,933
Shpenzime tatim fitimi i thjeshtuar K31624518B	-	110,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzime shkollimi	-	-	-	-	-	-	137,170	-	40,000	90,000	90,000	260,165	258,094	223,196
Shpenzime për shlyerjen e kredisë (principal+interes)	-	191,670	34,334	258,900	2,100,240	1,064,666	873,370	861,388	909,614	805,175	712,103	6,129,531	517,856	3,056,945
Shpenzime mobilimi	180,000	590,000	0	580,000	350,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzime nga llogaritë bankare për veshje	-	-	-	20,314	214,260	56,899	-	-	77,902	258,868	420,979	485,152	573,473	530,921
Shpenzime telefonie	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	105,914	178,664	237,098	457,026
Shpenzime qiraje	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	240,000
Shpenzime për aktivitetin sipas kontratave të kredisë	-	-	-	700,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzime kartë krediti (interesa dhe penalitete)	-	-	-	3,778	30,856	36,110	20,254	21,298	-	-	-	-	14,378	3,595
Pasuri	-350,000	-10,266	-85,664	2,274,273	4,524,766	136,400	443,849	244,126	447,304	636,166	95,732	1,741,653	1,270,608	-2,180,293
Kursime (Pakësim/Shtesa likuiditeti)	-1,000,000	-10,266	-85,664	438,639	292,916	-113,600	443,849	244,126	447,304	636,166	95,732	1,035,595	1,270,608	-2,180,293
Banese 3+1.L.4, Rr.Skenderbej, pall.405 Durres	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Autoveturë tip Renault DR 1000 D	650,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Autoveturë tip Renault DR 8999 D	-	-	-	750,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Autoveturë tip Opel DR 0001 F	-	-	-	1,085,633	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Rikonstruksion i banesës me sip.95 m2 + shtesë banese 38 m2	-	-	-	-	4,231,850	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Automjet tip FIAT PUNTO, DR 5100 E viti 1998	-	-	-	-	-	250,000	-	-	-	-	-	-	-	-
Automjet tip Benz Mercedes OY, AA 001 LT	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	379,848	-	-
Automjet tip SKODA Oktavia OY, AA 414 KB	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	326,209	-	-
Të ardhura + detyrime - shpenzime - pasuri	702,199	-74,147	384,706	-413,916	713,756	-351,535	1,054,581	-86,492	-34,855	-958,460	-418,887	-1,769,248	-89,609	364,757

Në përfundim, Komisioni, përgatiti analizën financiare të rishikuar për subjektin e rivlerësimit dhe konstaton se ai nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për të justifikuar investimet, kursimet dhe shpenzimet e kryera nga prej tij dhe personave të lidhur me të, duke rezultuar me një balancë financiare negative, përkatësisht në vitet 2004, 2006, 2008, 2010-2015, në vlerën prej 4,197,149 lekësh.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera prej tij dhe personat e lidhur, ndër vite.

Subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë lidhur me kreditë e marrë në Fondin Besa nga bashkëshortja e tij për qëllime biznesi, përkatësisht në vitet 2004 dhe 2006.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka dërguar në Komision me shkresën nr. *** prot, datë 15.5.2019, raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Ardian A. Ylli, i deklasifikuar plotësisht (raporti mbi kontrollin e figurës me nr. *** prot., datë 30.10.2007) dhe nga Grupi i Punës është konkluduar se:

“Për subjektin e rivlerësimit, z. Ardian A. Ylli, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar”.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacione nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo që ai të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar raportin vlerësues nr. *** prot., datë 14.9.2018, për subjektin e rivlerësimit, z. Ardian Ylli.

Në raportin e Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme janë evidentuar aftësi të mira të subjektit të rivlerësimit në lidhje me:

- a. aftësitë organizative;
- b. etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- c. aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Komisioni ka shqyrtuar tre dosjet e zgjedhura nga vetë subjekti, pesë dosjet e shortuara nga Komisioni, si dhe të dhëna nga burimet arkivore dhe të strukturave të tjera të Prokurorisë së Përgjithshme.

- **Tre dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.** Referuar raportit të përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme në tre prej tyre nuk konstatohen veprime të subjektit në shkelje me ligjin apo procedurën.
- **Pesë dokumentet e përzgjedhura me short.** Referuar raportit të përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme në pesë dosjet e përzgjedhura me short nuk konstatohen veprime të subjektit në shkelje me ligjin apo procedurën.
- **Të dhëna nga burime arkivore.** Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë e rretheve gjyqësore⁴⁸ në Republikën e Shqipërisë, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative, Sektorit të Protokoll – Arkivit, si dhe burimeve arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, nuk rezultojnë që subjekti i rivlerësimit, z. Ardian Ylli:
 - të ketë pasur masa disiplinore;
 - të ketë të dhëna apo indice të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta;
 - të ketë të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së tij në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale);
 - të ketë pasur ndaj tij materiale hetimore të regjistruara, procedime penale të pushuara, apo të pezulluara.
- Nga verifikimi i të dhënave të përcjella nga prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda ka rezultuar se ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Ardian Ylli, janë depozituar tri kallëzime penale përkatësisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, dhe Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë të cilat pas verifikimit nga prokuroritë respektive është vendosur mosfillimi i procedimit penal, ku këto vendime mosfillimi nuk janë ankimuar nga kallëzuesit.
- **Spektori Protokoll – Arkiv në Prokurorinë e Përgjithshme,** nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave, për periudhën 2006 – 2018, rezultojnë se janë bërë tetë ankesa ndaj subjektit të rivlerësimit. Nga këto ankesa, katër të tilla, janë bërë nga i njëjti shtetas N.D dhe katër të tjera janë bërë nga shtetas të tjerë.

Këto ankesa janë trajtuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe nuk ka rezultuar të kenë elementë për procedim disiplinor.

⁴⁸ Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, Berat, Sarandë, Krujë, Tropojë, Pogradec, Mat, Dibër, Kavajë, Kukës, Shkodër, Korçë, Gjirokastrë, Fier dhe Kurbin

- Komisioni, pasi ka analizuar ankesat e depozituara në Prokurorinë e Përgjithshme, ka pasur dyshimet e tij në lidhje me ankesën e bërë nga shtetasi Xh. A i cili ishte i pakënaqur nga hetimi i prokurorit Ardian Ylli (pasi në ngjarjen që po hetohej nga prokurori Ardian Ylli kishte humbur jetën në një aksident automobilistik i biri, N. A).

Për këtë arsye Komisioni ka kryer një korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës⁴⁹ dhe i ka kërkuar dosjen gjyqësore të kësaj çështjeje.

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e ndodhur në dosjen gjyqësore, ka konstatuar se nga prokurori i çështjes, z. Ardian Ylli, është kundërshtuar vendimi i gjykatës në lidhje me masën e sigurimit për lirin e personit të akuzuar për shkaktimin e aksidentit. Subjekti ka kërkuar që personi i akuzuar të mbetet në burg për shkak të rrezikshmërisë që paraqiste.

Në përfundim të procesit gjyqësor, subjekti Ardian Ylli, ka kërkuar dënimin e të pandehurit me 3 vite e 4 muaj burg, kërkesë kjo që është pranuar nga gjykata. Ky vendim është lënë në fuqi dhe nga Gjykata e Apelit Durrës.

D. DENONCIME NGA PUBLIKU

Për subjektin e rivlerësimit, z. Ardian Ylli, rezulton se deri në momentin e mbylljes së hetimit administrativ, janë bërë pesë denoncime nga publiku, konkretisht:

- **Denoncimi, datë 29.12.2017, i shtetasit A R.** Ky shtetas ngre ankesë për 38 subjekte (prokurorë dhe gjyqtarë të të gjitha niveleve) përfshirë dhe subjektin Ardian Ylli, duke e shpjeguar me faktin e persekutimit të tij si i përndjekur politik, përndjekje e cila i ka vazhduar edhe në ditët e sotme, ku përfshihet dhe politika e cila ka krijuar dhe këtë situatë me gjyqtarët dhe prokurorët e vendosur prej saj.

Në denoncimin e tij ky shtetas ngre pretendime, duke kërkuar zgjidhjen e tyre nga Komisioni, ndërkohë që nga verifikimi i tyre rezulton se këto pretendime realizohen me rrugë gjyqësore duke iu drejtuar gjykatave më të larta.

- **Denoncimi, datë 20.3.2018, i shtetasit G. T.** Ky shtetas ka denoncuar 50 subjekte (gjyqtarë dhe prokurorë të të gjitha niveleve) përfshirë dhe subjektin Ardian Ylli dhe ankohet ndaj subjektit Ardian Ylli, i cili së bashku me prokurorë të tjerë dhe duke përfshirë drejtuesit e Prokurorisë Krimeve të Rënda dhe Prokurorisë së Apelit Vlorë dhe ish-Prokurorin e Përgjithshëm, në kundërshtim flagrant me ligjin, kryen arrestimin e tij dhe fillimin e paligjshëm të ndjekjes penale, dhe ngre ankesa dhe ndaj të gjithë gjyqtarëve që kanë marrë vendime gjyqësore kundër tij dhe ndaj të gjitha vendimeve gjyqësore që i konsideron të padrejta

Komisioni vëren se nga denoncuesi nuk janë referuar të dhëna konkrete, nuk janë bashkangjitur prova dhe për rrjedhojë nuk rezulton të ketë indice për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore.

- **Denoncimi, datë 12.4.2018, i shtetasës L. Z.** Shtetasja L.Z ankohet ndaj 4 subjekteve të ndryshëm duke i akuzuar se kanë bërë veprime korruptive, si prokurorët dhe gjyqtarët

⁴⁹ Shkresa e Gjykatës së Rrethit Durrës nr.***prot, dt.30.05.2019 shoqëruar me dosjen gjyqësore përkatëse.

që kanë gjykuar çështjen. Është konstatuar se subjektin Ardian Ylli, denoncuesja nuk e përmend tek ankesa që ngre për subjektet e tjera.

- **Denoncimi, datë 23.1.2019**, shtetases L. Z. Kjo shtetase ankohet ndaj 10 subjekteve të ndryshme përfshirë edhe subjektin Ardian Ylli.

Në dy denoncimet e saj ajo trajton të njëjtat problematika pasi këto subjekte kanë abuzuar duke shpërdoruar detyrë.

Në lidhje me subjektin Ardian Ylli, denoncuesja ka bashkangjitur dhe një vendim mosfillimi të kallëzimit penal nr. ** të vitit 2015, për veprën penale të fyerjes dhe dëmtime të tjera me dashje.

Për këtë rast Komisioni analizoi që duhet verifikuar dokumentacioni i dosjes dhe për këtë arsye ka kryer korrespondencë me Prokurorinë e Rrethit Fier.

Nga dosja rezultoi se është marrë vendimi i mosfillimit për kallëzimin e bërë nga denoncuesja L.Z nga prokurori i çështjes Ç. S., pasi vepra në fjalë ndiqet nga vetë kallëzuesi në gjykatë dhe nuk ka elementë të veprës penale që ndiqet nga prokurori. Subjekti Ardian Ylli ka qenë në rolin e drejtuesit të prokurorisë që ka konfirmuar vendimin e mosfillimit.

Nga Komisioni nuk vërehen indice apo elementë për përgjegjësi disiplinore për subjektin Ardian Ylli.

- **Denoncimi, datë 31.7.2018, i shtetasit A.Ç.** Shtetasi A.Ç ka denoncuar prokurorin e çështjes V. SH., dhe subjektin Ardian Ylli si drejtues prokurorie, pasi pretendon se është proceduar në mënyre arbitrare nga një kallëzim i rremë dhe se dy subjektet kanë dalë mbi ligjin.

Komisioni ka kryer korrespondencë me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, duke kërkuar dosjen me të cilën denoncuesi A. Ç. është proceduar për veprën penale “të mashtrimit”.

Prokuroria ka kërkuar deklarimin fajtor të denoncuesit dhe dënimin e tij me 7 vjet burg, ndërkohë që kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata e Rrethit Fier, duke e dënuar denoncuesin po me 7 vjet burg. nga Gjykata e Apelit Vlorë ky vendim u ndryshua, duke pezulluar dënimin me burg dhe konvertuar me 3 vjet periudhë prove.

Denoncuesi pretendon se në Gjykatën e Lartë do ta zgjidhte përfundimisht çështjen

Komisioni nuk vëren të ketë prova apo indice për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore.

❖ **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

Komisioni, pasi analizoi informacionin dhe dokumentacionin që përmbanin këto denoncime, vlerësoi se në këto denoncime nuk konstatoi indice apo problematika që çojnë në paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional

Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, në gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe konsiderohet “i aftë”.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2, të nenin 4, nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në pikën 3, të nenin 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ardian Ylli, me funksion prokuror/drejtues i komanduar i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
2. Vendimi i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 18.7.2019

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Roland ILIA
Kryesues

Olsi KOMICI
Relator

Valbona SANXHAKTARI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha